

Nr.	Data e Regjistrimit të kërkesës	Data e Kthimit të Përgjigjes	Kërkesa	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës
1	03.04.2023	06.04.2023	Informacion për të siguruar mjekim me medikament të caktuar në farmaci.	Informacion, kontaktim me pacientin dhe personin përkatës për zgjidhjen e problematikës.	E plotë
2	04.04.2023	13.04.2023	Informacion për t'u interesuar në cilin institucion në lidhje me kartelë shëndetësore dhe nëse ka mundësi për një adresë të tij	Informacion se në zbatim të VKM Nr. 914, datë 04.07.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Sherbimit të Kujdesit Shëndetësor", adresimi i kërkesës tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Operatorit të Sherbimit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.	E plotë
3	05.04.2023	14.04.2023	Informacion për ekzaminim të kryer në Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Qendres Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.	E deleguar
4	07.04.2023	28.04.2023	Informacion nëse ka rregulloren për mënyrën e trajtimit dhe të rigjenerimit të mbejeteve spitalore, nëse po cilat janë; cilat janë sasitë vjetore të mbejeteve spitalore të gjenhuara nga spitalet	Informacion se të gjitha spitalet në Republikën e Shqipërisë zbatojnë VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 "Për Miratimin e Rregullores "Për Administrimin e Mbejeteve Spitalore" (Fletore Zyrtare Nr.156, datë 26.11.2010) dhe lidhur me pikën 2, referuar informacionit të siguruar, konstatohet se për këtë pikë të kërkesës suaj ju jeni drejtuar të gjitha spitalet nga ku rezultojnë se keni marrë përgjigje prej tyre.	E plotë
5	10.04.2023	25.04.2023	Informacion nëse keni njohuri nëse Posta Shqiptare ka miratuar Planin e Masave për eliminimin e pengesave për personat me afësi të kufizuara dhe nëse jo a është marrë ndonjë masë duke qenë se jeni klient i rëndësishëm i Postës Shqiptare	Informacion se Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me afësi të kufizuara" përcakton përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe populike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me afësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri. Për sa i përket monitimit të Ligjit Nr.93/2014 dhe akteve nënligjore nga MSHMS është evidentuar situata e aksesueshmërisë në institucionet qendrore, e cila rezultojnë me përmirësime prej miratimit, ndërsa aksesueshmëria është një proces në vazhdimësi për çdo institucion publik dhe privat. Njëkohësisht, është në proces hartimi i raportit dy-vjetor të monitorimit 2021-2022 për shërbime gjithëpërfshirëse të aksesueshme për personat me afësi të kufizuara, me rekomandimet tona si autoriteti monitorues.	E plotë
6	11.04.2023	19.04.2023	Informacion nëse ka një raport të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për mënyrën se si ndikon pagesa e lejes së lindjes për lindjet e reja; si e ndikon një nënë pagesa e lejes së lindjes; nëse ka propozuar institucioni juaj një rishikim të ligjit për sigurimet shoqërore për pagesën e barrëlidhjes; nëse keni zhvilluar konsultime për rishikimin e ligjit të vitit 2014 për pagesën e barrëlidhjes me grupet e interesit dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji; cila është politika apo strategjia në të cilën pagesa e barrëlidhjes në nënë nga viti 2015-2022 zbatuar nga institucioni juaj	Informacion se pagesat e lejes së barrëlidhjes rregullohen sipas Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligji i cili nuk është në fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pikat 1-4 të kërkesës suaj përcillen për trajtim dhe kompetencë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Lidhur me politikat apo strategjitë e suksesshme në mbrojtje të nënave nga viti 2015-2022 zbatuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, informojmë se: Nënkat kanë një vëmendje të veçantë në skemën e mbrojtjes sociale, ku ndër masat kryesore sociale që janë marrë përmendim:1. Dyfishim i masës së ndihmës ekonomike për gratë kryefamiljare përfutuese të kësaj skeme dhe dyfishim i masës për familjet me tre apo më shumë fëmijë;2. Mbështetje financiare në masën 20,000 (njëzet mijë) lekë për zbutjen e efekteve të krijuara nga inflacioni për gratë kryefamiljare përfutuese të skemës së ndihmës ekonomike ;3. Zbatimi i programit të mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, program i cili ka filluar të zbatohet që prej janarit të vitit 2023.Në zbatim të VKM Nr. 751, datë 1.12.2022 "Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç", grave të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100,000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare, njëdit si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëlidhjeje. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paguhet në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi. Aktualisht për muajin Janar, përfitojnë nga ky program rreth 5,200 gra të papuna me tre apo më shumë fëmijë.Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është duke punuar dhe ka në fokus, hartimin dhe zbatimin e strategjive për mbrojtjen e nënave.	E deleguar; E plotë
7	11.04.2023	27.04.2023	Informacion se nga cila datë përcaktohet paralindja	Informacion se në nenin 11 "Raport Mjekësor për lehtë barrëlidhjeje", pika 1.1. e Rregullores Nr. 2666/1, datë 21.6.2022 "Për kriteret, rregullat dhe procedurat e lëshimit të raporteve mjekësore elektronike për paafhtësi dhe përkohshme për punë, për barrëlidhje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale" përcaktohet se: "Raporti mjekësor për lejen e paralindjes prej 35 ditësh kalendrike, lëshohet nga mjeku obstetër-gjinekolog dhe atje ku nuk ka të tillë nga mamia, e drejtë që fillon në moshën e bartsë 35-javëshe të gruas". Për më tepër, ju mund të konsultoni këtë Rregullore e cila gjendet e publikuar në Fletoren Zyrtare Nr.102, datë 08.07.2022.	E plotë
8	14.04.2023	27.04.2023	Informacion në lidhje me emërtimin zyrtar të institucionit shëndetësor Qendra Spitalore "Xhafer Kongoli" Elbasan dhe numrin e tij të identifikimit (NIPT-in)	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Spitalit Elbasan.	E deleguar
9	14.04.2023	20.04.2023	Informacion në cilin ligj, nen apo urdhëresë është mbështetur dhënia e statusit të "Autonomisë Menaxheriale" të Spitalit "Memorial" në Fier; nëse është menduar impakti pozitiv apo negativ që prek qytetarët fierakë e jo vetëm nga ndryshimi i statusit; nëse është menduar për kostot financiare të një të siguruarit që mund të marrë shërbim në këtë spital me statusin e ri; nëse është i parakohshëm dhënia e këtij statusi ende pa u miratuar ligji, është ligjor statusi menaxherial në rastin konkret për "Memorial-in" në Fier; kush mban përgjegjësi për vendimin që është marrë ende pa kaluar ligji në Kuvendin e Shqipërisë; dërgimin e një kopje të projektligjit "Për Autonominë Spitalore"; emrin e institucionit tek i cili mund të ankohej për këtë projektligj ende të pamiratuar nga Kuvendi i Shqipërisë	Informacion se Ligji Nr.55/2022 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë" është miratuar dhe ka hyrë në fuqi me Dekretin Nr.13838, datë 01.08.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Referuar nenit 31, Dispozitat Transitore, të Ligjit Nr.55/2022 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë", parashikon se: "Spitali Memorial në Fier, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, për një periudhë 2-vjeçare aplikon autonominë menaxheriale, si një spital pilot, i krijuar në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Turke". Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.72, datë 08.02.2023, ka miratuar Rregulloren e Autonomisë Spitalore, e cila ngarkon MSHMS-në si dhe institucionet e saj të varësisë dhe vetë spitalet autonome për zbatimin e këtij vendimi. Me qëllim për të përcaktuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier si aplikues i autonomisë spitalore menaxheriale, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.687, datë 26.10.2022 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, si aplikues i autonomisë spitalore menaxheriale. Spitali Rajonal Memorial Fier, ofron veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor dhe bazuar në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, ratifikuar me Ligjin Nr.23/2012, me seli në Fier, pjesë e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.	E plotë
10	17.04.2023	28.04.2023	Informacion nëse Spitali Rajonal Elbasan vepron me NIPT-in aktual	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Spitalit Elbasan.	E deleguar

11	19.04.2023	11.05.2023	Informacion për aplikim në QKL për ushtrim profesioni infermier si i vetëpunësuar që është refuzuar për disa pika të cilat janë dorëzuar në aplikim	Informacion se Leja e Ushtrimit të Profesionit Infermier lëshohet nga "Urdhri i Infermierit të Republikës së Shqipërisë". Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk licencen për ushtrimin e profesionit infermier si i vetëpunësuar dhe sqarojnë se nuk ka një licencë të tillë më vete për infermier, por për ushtrimin veprimtarie/biznesi ku konkretisht veprimtaritë që licencohen në fushën e shëndetësisë referuar VKM Nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, janë si më poshtë vijon: II.6.A.1 Shërbime laboratorike : Laborator mikrobiologjik II.6.A.1 Shërbime laboratorike : Laborator klinik biokimik II.6.A.1 Shërbime laboratorike : Laborator gjenetik II.6.A.1 Shërbime laboratorike : Laborator dentar II.6.A.1 Shërbime laboratorike : Laborator optik II.6.A.2 Kabinete mjekësor II.6.A.3 Klinikë stomatologjike II.6.A.3 Kabinete stomatologjike II.6.A.4 Qendër Mjekësore II.6.A.5 Shërbime të tjera shëndetësore kurative II.7.A.1.F Farmaci II.7.A.1.A.F. Agjenci Farmaceutike II.8.A Shërbime ekspertize higjieno-sanitare II.8.B Shërbime ndërhyrëse higjieno-sanitare Në rast aplikimi për aktivitetet e sipërcituara, subjekti mund të jetë i punësuar në një Qendër Mjekësore ose Kabinete Mjekësor, prandaj ose do të jetë pronar i klinikës ku do të ketë një drejtes teknik mjek dhe vetë të jetë i punësuar.	E plotë
12	19.04.2023	04.05.2023	Informacion për përbërësit dhe të dhënat toksikologjike, nëse duhet të jenë kryer së pari analizat e produkteve të duhanit pranë Agjencisë Kombëtare të Duhanit dhe Cigareve dhe të depozitojmë përgjigjen e këtyre analizave apo këto të dhëna mund të jenë marrë nga furnitori i huaj dhe shkresa e njoftimit t' i dërgohet ministrit tuaj përpara se të kryhen analizat pranë agjencisë përkatëse	Informacion se kompanitë importuese të produkteve të duhanit sipas Ligjit Nr.9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar, duhet të njoftojnë me shkrim Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hedhjen në treg të produkteve të reja 30 ditë më përpara importit, në formën e një vetëdeklarimi. Nuk është e nevojshme analiza e produkteve nga institucionet shqiptare, por vetëm të dhënat mbi përbërësit që janë të disponueshëm nga kompania prodhuese.	E plotë
13	20.04.2023	04.05.2023	Informacion si duhet proceduar për të rifilluar punë si infermier dhe kryerje të provimit për t'u listuar në portal	Përcjellë për trajtim dhe kompetencë Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.	E deleguar
14	20.04.2023	27.04.2023	Informacion nëse projektvendimi për pagat është i përfunduar dhe se çfarë kategori mjekësh preken	Informacion se është miratuar nga Këshilli i Ministrave më datë 20.04.2023 (https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-20-prill-2023)/Vendimi "Për disa ndryshime në Vendimin nr.555, datë 11.8.2011, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalit përkatës", të ndryshuar.	E plotë
15	21.04.2023	04.05.2023	Informacion mbi shpenzimet e kryera në vitin 2022 vetëm nga Ministria e Shëndetësisë-vitin e kaluar, gjatë përgatitjes së raportit "Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor", për të cilin na përcollët informacion shumë të vlefshëm mbi shpenzimet e MSHMS (2020-2021) në lidhje me qendrat e ndryshme për viktimat e dhunës, apo aktivitetet ndërgjegjësuese (të mbukura dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë)	Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale financon dy shërbime mbështetëse të specializuara në nivel kombëtar, në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, të cilat ofrojnë strehim dhe trajtim afatgjatë me fokus riintegrimin, për viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit të qenieve njerëzore.Të dhënat mbi buxhetin e planifikuar dhe alokuar për këto dy qendra: Institucioni-Financimi i vitit 2022 Qendra Kombëtare për Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare -21,530,000 Qendra Kombëtare Prithëse e Viktimave të Trafikimit-22,350,000 Mekanizmi i Fondit Social është një burim i rëndësishëm i mbështetjes financiare për sa i përket financimit apo bashkëfinancimit të shërbimeve në fushën e parandalimit dhe përkrahjes së viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor, qarqe dhe bashki. Gjatë vitit 2022 në kuadër të Fondit Social janë financuar 12 shërbime parandaluese dhe mbështetëse për dhunën në familje dhe me bazë gjinore me vlerë 65,807,761 lekë. Për vitin 2022 ka vijuar financimi nga Fondi Social për shërbimin trajtimi i viktimave të dhunës në familje dhe në situatë rreziku, në tre bashki të vendit si: Gjirokastrë, Berat dhe Kukës, me vlerë të financuar të shërbimit 7,126,725 lekë si dhe për ofrimin e 2 shërbimeve të specializuara në qarkun Tiranë për Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza (116 117) dhe Qendrën "STREHA". Shërbimi i asistencës për integrimin dhe fuqizimin e të rinjve LGBTI dhe viktimat të dhunës, në risk dhe të pastrehë, me vlerë të financuar të shërbimit 12,768,552 lekë Parandalimi përmes shërbimeve:Informojnë se zgjerimi i hartës së shërbimeve me ofrimin e shërbimeve komunitare multifunkionale, ka në fokus parandalimin e problemeve që shkaktojnë dhe nxisin dhunën në familje, përmes ofrimit të programeve fuqizuese të familjes si një entitet, gjithmonë përmes këshillimit dhe ndërgjegjësimit të grave dhe vajzave, për të garantuar respektimin e lirisë dhe të drejtave të tyre familjare, sociale dhe ekonomike.Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka mbështetur nga Fondi Social ofrimin e shërbimeve multifunkionale në 4 bashki për vitin 2022, si: Durrës, Elbasan, Sarandë dhe Devoll. Vlera e financuar për vitin 2022 nga Fondi Social për shërbime komunitare multifunkionale është 16,179,731 lekë.Me synim parandalimin e abuzimit dhe rrezikut të trafikimit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ofron mbështetje financiare për 3 shërbime të specializuara të antitrafikimit, në 3 qarqe të mëdha të vendit si: Tiranë, Elbasan dhe Vlorë në masën 29,0879,324 lekë. Për vitin 2022 raportohet referimi dhe mbështetje për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre për më shumë se 327 përfitues, gra dhe vajza, si dhe fëmijët e tyre sipas rastit. Nga programi i ndihmës ekonomike për vitin 2022 kanë përfituar 1017 viktimat dhunë në masën 9,900 lekë në muaj.	E plotë

16	26.04.2023	11.05.2023	Informacion për vendosje në dispozicion kopje dokumenti ose linku për: 1. Udhëzimi i ISSH nr 20, datë 10.01.2001 "Për zbatimin e ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik"; 2. Urdhri nr. 546 datë 16.12.2021 "Për ngritjen e grupeve të kontrollit të përfutimeve të statusit të paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve"	Informacion se bashkëlidhur ju vendosim në dispozicion kopje të Urdhrit Nr. 546, datë 16.12.2021 "Për ngritjen e grupeve të kontrollit të përfutimeve të statusit të paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve". Lidhur me pikën 1 të kërkesës, sqarojmë se ajo është në kompetencë të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, së cilit i është përcjellë gjithashtu për kompetencë dhe trajtim kërkesa juaj sikundër ju jeni në dijeni.	E plotë
17	26.04.2023	11.05.2023	Informacion për respektimin e të drejtave të të burgosurve dhe të paraburgosurve: sa është numri zyrtar i të burgosurve dhe të paraburgosurve që u infektuan me Covid 19 gjatë pandemisë; nëse pati viktima nga corona virusi mes personave që vuanin dënimin ose ishin të izoluar në HEVP-të shpirtërore, nëse po, sa ishte numri; nëse ka Ministria e Shëndetësisë ndonjë program të veçantë për të burgosur apo të paraburgosur që kanë nevojë për trajtim si përdorues droge; nëse po, sa po mjekohen e si po mjekohen	Informacion se pika 1 dhe 2 e kërkesës suaj përcillet për trajtim dhe kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgeve. Lidhur me pikën 3 dhe 4 të kërkesës, sqarojmë se kujdesi shëndetësor i të burgosurve ofrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgeve, Ministria e Drejtësisë, Nderkohë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ofron asistencën e nevojshme shëndetësore për personat e burgosur (urgjencat shëndetësore, kryerje ekzaminimesh, konsulta të zgjeruara, ndërhyrje kirurgjikale, etj) nëpërmjet shërbimeve të specializuara në institucionet spitalore rajonale dhe në rast kur është e mundur ofrimi i shërbimit në këto institucione, referohen pranë QSUT. Në këtë kuadër, edhe personat e burgosur abuzues substancash trajtohen në institucionet spitalore rajonale dhe pranë Shërbimit të Adiktologjisë dhe Toksikologjisë Klinike në QSUNT apo shërbime të tjera sipas nevojave. Për sa i përket trajtimit mbajtës me metadone, informojmë se këto shërbime janë të disponueshme në burje, nëpërmjet partneriteteve ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile që ofrojnë këto shërbime me mbështetjen e Fondit Global dhe sistemit shëndetësor të burjeve. Terapia e mbajtjes me metadon (MMT) ofrohet bazuar në "Udhëzimet Klinike të Terapisë së mbajtjes me Metadon (MMT)" të miratuara në 2019 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Më shumë informacion dhe të dhëna lidhur me këtë çështje disponon Drejtoria e Përgjithshme e Burgeve.	E deleguar; E plotë
18	27.04.2023	23.05.2023	Informacion për numër personash që i përkasin minoritetit rom dhe egjiptian të cilët janë të punësuar në institucione shkollore publike sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Pakicat Romë dhe Egjiptiane; shkollat ku janë punësuar, emrat e shkollës dhe qytetet; numër personash të punësuar në harkun vjetor 2014-2023 sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Pakicat Romë dhe Egjiptiane	Informacion se Plani Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, nxitin e promovojnë punësimin dhe integrimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës. Emërimi i mësuesve në sistemin arsimor realizohet përmes portali "Mësues për Shqipërinë", me të drejtë aplikimi për punësim nga çdo qytetar pa parakusht vetëdeklarimim e emisë. Nderkohë bëjnë me dije se, vetëdeklarimi në sistemin arsimor kryhet në aplikimin e studentëve për bursë shkollore dhe realizohet mbështetur në ligjet përkatësisht: Ligji Nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, Ligji Nr.110, datë 20.12.2018 "Për Notarinë", i ndryshuar. Për sa i përket punësimit në sistemin arsimor, rezultojnë rreth 80 mësues nga pakicat romë/egjiptiane prej vitit 2015 deri në vitin 2022 mbështetur në të dhënat e sistemit Rom-Ab. Gjithashtu nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është përfunduar roli i mediatorëve në arsimin gjithëpërfshirës duke u mbështetur me akte nenligjore. Në arsimin e formimit profesional përgjatë periudhës kohore 2016-2021, janë punësuar mësues që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, përkatësisht në shkollat e rrethëve si: Tiranë, Elbasan, Korçë, etj. Objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, përgjatë periudhës 2021-2025, synojnë qasje të barabartë në shërbime, arsim, shëndetësi, punësim, formim profesional, mbrojtje dhe përfshirje sociale. Në sektorin e arsimit janë punësuar si mësues ose edukatorë persona nga pakicat rom/egjiptiane. Njëkohësisht, në zbatim të masave të Planit Kombëtar rezultojnë se gjatë vitit 2022 janë punësuar në programet aktive të punësimit dhe formimit profesional rreth 1056 Romë dhe Egjiptianë.	E plotë
19	30.04.2023	11.05.2023	Informacion nëse mund të merret receta e ilaçeve nga mjeku nëpërmjet e-albania	Informacion se të gjitha shërbimet të cilat ofrohen në e-Albania nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e saj të varësisë i gjeni të publikuara në https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=47&service_type=Y dhe https://ealbania.al/eAlbaniaServices/DependantInstitutions.aspx?id=47&service_type=Y&shoë_service_link=Y .	E plotë
20	02.05.2023	08.05.2023	Informacion për punësimin në qendrat e plazhit për sezonin veror, ku mund të bëhet aplikimi	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.	E deleguar
21	02.05.2023	17.05.2023	Informacion për aktet nenligjore të nenit 32 të ligjit 22/2022 të nxjerra nga Këshilli i Ministrave pas hyrjes në fuqi të ligjit 22/2022; VKM-së nr.72, datë 08 korrik 2023; dokumentin e këshillit të ministrave për statusin e autonomisë menaxheriale për Spitalin "Memorial", Fier datë 7 korrik 2023 (i cili përcakton edhe afatin dy vjeçar deri më 7 janar 2024); aplikimin e Spitalit Memorial Fier për statusin e autonomisë menaxheriale; konfirmimin e pranuar nga Ministria e Shëndetësisë për këtë status; rregulloren e Spitalit Memorial Fier; tarifat e të gjitha shërbimeve të Spitalit Memorial Fier	Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr.prot. Gj-7/1, datë 20.04.2023 "Kithim Përgjigje" drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për dënimin tuaj si kërkuar, ka cituar bazën ligjore së bashku me informacionin për sa i përket pikave 1-5 të kërkesës suaj. Në lidhje me pikën 6, informojmë se është miratuar Urdhri Nr.183/3, datë 07.05.2021 "Për Miratimin e Statusit të Spitalit Rajonal Memorial Fier", të cilit e gjeni bashkëlidhur. Sa i përket pikës 7, informacioni disponohet prej Spitalit Rajonal Memorial Fier dhe mund të merret pranë këtij spitali.	E plotë
22	02.05.2023	08.05.2023	Informacion për listën e numrave të loteve të vaksinave Pfizer-Biontech të muajve nëntor 2022-shkurt 2023; numër personash të vaksinuar gjatë kësaj periudhe me dozë të parë dhe të dytë	Informacion se gjatë periudhës nëntor 2022-shkurt 2023 kanë ardhur në total 698 880 doza vaksine, përkatësisht Comirnaty Pfizer-Biontech B.4-5 (650 880 doza) me numër loti GJ2544 dhe Comirnaty Pfizer-Biontech Pediatric (48 000 doza) dhe numër loti GE0694. Gjatë kësaj periudhe janë aplikuar 61 110 doza të para dhe 7911 doza të dyta vaksinash.	E plotë
23	03.05.2023	08.05.2023	Informacion nëse do të hapen qendrat shëndetësore këtë verë dhe nëse po si do të behen aplikimet për to	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.	E deleguar
24	03.05.2023	08.05.2023	Informacion në lidhje me qendra shëndetësore në qytetin e Fierit në të cilat janë punësuar punonjës social dhe/ose psikologë	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.	E deleguar

25	03.05.2023	04.05.2023	Informacion për procesin e aplikimit në shërbimin e pacientëve në Turqi	Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vetëm marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë Turke në lidhje me trajtimin e pacientëve falas. Pacienti nuk mund ta zgjedhë vetë spitalin, por përcaktohet nga organet perkatese në shtetin turk. 1. Aplikimi në Ministrinë e Shëndetësisë së Turqisë kërkon plotësimin e dokumentacionit :1. Epikrizë nga Shërbimi Përkates i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" ; 2. Vendim Komisioni nga Qendër Spitalore Universitare "Nënë Tereza si raste, që nuk mund të trajtohen në vendin tonë. Me të patur këto dy dokumenta (të përkthyer dhe të noterizuara në anglisht) mund të aplikojnë për në Turqi, pranë Ministrisë sonë të Shëndetësisë.	E plotë
26	04.05.2023	25.05.2023	Informacion për dhënien e shërbimit shëndetësor bazë pensionistëve që nuk kanë mundësi të kujtesen dot për veten e për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore të tyre; nëse ka mundësi shteti për t'i lidhur/punësuar një person disa orë paradite përgjatë pesë ditëve punë të javës për t'i dhënë shërbime bazë siç janë ilaçet dhe ushqimi	Informacion nga Shërbimi Social Shtetëror se rasti juaj është diskutuar me përfaqësuesit e Qendrës "Aset" dhe specialistët e s'ajdo të vendosen në kontakt me ju. Për të verifikuar ndjekjen e rastit tuaj ju mund të vendoseni në kontakte të mëtejshme me Shërbimin Social Shtetëror në adresë postare: "Rruga e Durrësit", Nr.83, Tiranë; e-mail: info@sherbimisocial.gov.al; Numër telefoni: 00355 04 4 541 821; 00355 04 4 541 822.	E plotë
27	05.05.2023	23.05.2023	Informacion se cilave kategori të bluzave të bardha (mjekët e familjes, karidologët, gjinekologët,etj) ju janë rritur pagat; sa e kanë pasur pagën mujore kategoritë e bluzave të bardha përpara se të përfitonin rritjen (përcaktoni secilin kategori); me sa % janë rritur pagat mujore kategoritë e bluzave të bardha që përfituan rritjen e pagës; me çfarë fondi ju janë rritur pagat kategoritë e bluzave të bardha që përfituan rritjen; nëse kanë qenë dakord të publikoheshin në faqen e MSHMS apo dhe në faqet e tjera personat që kanë përfituar rritje	Informacion se i janë rritur pagat në sistemin shëndetësor të gjithë personelit shëndetësor që përfshihen në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 245, datë 20.04.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkates", të ndryshuar si dhe personelit shëndetësor që përfshihen në Udhëzimin nr. 1, datë 03.05.2017 "Për mënyrën e pagës dhe shpërblimit për punonjës të qendrave shëndetësore nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor", i ndryshuar. Pagat mujore të bluzave të bardha sipas kategorive përcaktohen në Vendimin Nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkates", të ndryshuar. Paga e personelit shëndetësor me specialitet është rritur me 50,000 lekë/muaj, paga për mjekët e përgjithshëm/infermierët/laborantët/teknikët e shkencave mjekësore është rritur me 7%. Fondi për rritjen e pagave ka burim buxhetin e shtetit për vitin 2023.	E plotë
28	05.05.2023	12.05.2023	Informacion sa zgjat procedura për marrjen e vullës katrore nga Ministria e Shëndetësisë; nëse dokumentacioni duhet të silltet me postë apo dorazi dhe sa kohë duhet për vullosje	Informacion se dokumentet për vullosje mund të sillen dorazi ose të dërgohen me postë, e cila është në vlerësimin tuaj. Në rast se ju do të paraqesni dokumentet në institucionin tonë dorazi, ato dorëzohen në reception, të cilat vulosen nga institucioni sapo merren në dorëzëm dhe nuk ka vonesa në procedurë. Ju mund t'i tërhiqni dokumentet e vulosura duke u paraqitur pranë receptionit të institucionit tonë.	E plotë
29	09.05.2023	11.05.2023	Informacion për rinovim patente dhe vazhdim kontrolli tek specialistët, pasi sipas Udhëzimit nr.205, datë 07.05.2023, pika 7 vetëm pacientët e pasiguruar paguajnë vizitën tek specialisti	Informacion prej vetë kërkuarit se është sqaruar për kërkesën e tij nga drejtuesit e shërbimit shëndetësor.	E plotë
30	10.05.2023	23.05.2023	Informacion se si ka ecur procesi i vaksinimit dhe nëse vijnë qytetarët të vaksinohen	Informacion se në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mund të gjeni të dhënat lidhur me Covid 19 në linkun https://shendetesia.gov.al/covid-19-dhe-vaksinimi-anti-covid/ . Gjithashtu ju mund të konsultoni linkun https://shendetesia.gov.al/category/lajme/ për të dhënat më të fundit përfshirë dhe situatën lidhur me Covid19.	E plotë
31	12.05.2023	22.05.2023	Informacion për marrje masash dhe verifikimi të situatës së rëndë nga hedhja e mbeturinave dhe rrjedhja e ujërave të zeza	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.	E deleguar
32	14.05.2023	24.05.2023	Informacion për vendin e ankimit për mjek për shkelje të legjislacionit mjekësor përveç atyre të të drejtave themelore të njeriut e kodit penal	Informacion për të paraqitur ankesën në Urdhri i Mjekëve të Republikës së Shqipërisë, me adresë: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati i ri LI-EM, Laprakë (pranë Bankës Pro Credit) Tiranë.	E plotë
33	19.05.2023	31.05.2023	Informacion se kur mund të hidhen fondet në lidhje me bonusin e bebeve të porsalindura	Informacion se llogarisë bankare të bonusit të bebeve i kalohen çdo javë fonde dhe si rrjedhojë në asnjë moment nuk ka pasur problematika me mungesën e fondeve.	E plotë
34	22.05.2023	25.05.2023	Informacion në lidhje me përfitim të bonusit të bebeve për personat që jetojnë jashtë Shqipërisë; ndërkohë fëmija ka lindur janar 2023 por në pamundësi ardhje nuk e kemi bërë aplikimin për tërheqjen e bonusit të bebeve; informacion nëse mund të vij dhe të bëj aplikimin për të përfituar këtë bonus	Informacion se deri në miratimin e ndryshimeve ligjore, mbeten në fuqi masat e përfitim të ligjit aktual.	E plotë

35	22.05.2023; 26.06.2023	24.07.2023	<p>Informacion për vënie në dispozicion të dokumenteve zyrtare "Relacion Shpjegues" të VKM-ve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, gjatë vitit 2023; 257, datë 20.04.2023: "Për një ndryshim në vendimin nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023"; 295, datë 17.5.2023: "Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Fatmir Prifti"; 314, datë 24.5.2023 "Për miratimin e llojeve dhe procedurave të lidhjes së marrëveshjeve të posaçme (MEA).</p>	<p>Informacion për vendosje në dispozicion bashkëlidhur kopje të relacionit të VKM-së nr. 314, datë 24.5.2023 "Për miratimin e llojeve dhe procedurave të lidhjes së marrëveshjeve të posaçme (MEA) dhe VKM-së nr. 257, datë 20.4.2023 "Për një ndryshim në vendimin nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023". Informacion se relacioni për VKM-në nr.295, datë 17.5.2023 "Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Fatmir Prifti" përmban të dhëna personale dhe sensitive dhe si t ë tilla këto të dhëna janë anonimizuar duke f u referuar përcaktimeve të nenit 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të ndryshuar, për përpunimin e të dhënave personale i cili bëhet nëse jep përkujtimin subjekti i këtyre të dhënave.</p>	E plotë
36	26.05.2023	13.07.2023- 13.07.2023	<p>Informacion për numrin e fëmijëve jetim në Shqipëri për numrin e fëmijëve jetim të cilët nuk kanë nënën; numri i fëmijëve jetim të cilët nuk kanë babain; numri i fëmijëve jetim të cilët nuk kanë të dy prindërit; numri i fëmijëve në Shqipëri të cilët janë me status jetimi; cila është menyra sesi një fëmijë e fiton statusin e fëmijës jetim; cila është ndihma që parashikon Ministria e Mbrojtjes Sociale për këtë kategori; si përcaktohen shuma në para që merr një fëmijë jetim, pas vdekjes së njërit prej prindërve (pensioni që marrin deri në 18 vjeç); informacion në rast se një familje e cila trajtohet me ndihmë ekonomike qëllon që humb njërin nga prindërit (nënën ose babain) dhe fëmijët fillojnë dhe trajtohen me pensionin e babait ose nënës, nëse e humb të drejtën e ndihmës ekonomike; informacion nëse një fëmijë humb nënën, a përfiton ai ndihmë nga shteti dhe nëse po si</p>	<p>Informacion për pikën 8 se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk disponon të dhëna mbi numrin e fëmijëve jetim në Shqipëri, pasi në bazë të Ligjit Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit", i ndryshuar, disponohen të dhëna për ata fëmijë që aplikojnë për të përfutur statusin, i cili përfshihet bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 1, të Ligjit Nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit", i ndryshuar, duke aplikuar për marrjen e statusit pranë Shërbimit Social Shtetëror.</p> <p>Konkretisht përfshijnë statusin e jetimit personat me moshë 0-25 vjeç, që kanë kaluar ose jo nëpër institucione shtetërore a private të përkujdesit shoqëror dhe që plotësojnë këto kriteret:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të lindurit jashtë martesë. 2. Nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit. 3. Të cilëve me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton më. 4. Që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre". <p>Të dhënat që disponojnë lidhur me numrin e fëmijëve që trajtohen me status jetimi dhe konkretisht numri i fëmijëve që trajtohen me këtë status dhe nuk kanë gjallë asnjë nga prindërit është 267 persona, numri i fëmijëve të cilët janë me status jetimi është 888 persona, nga të cilët 845 janë të grupmoshës 0-18 vjeç dhe 43 prej tyre janë të grupmoshës 18-25 vjeç.</p> <p>Lidhur me ndihmën që jepet për fëmijët me status jetim, ajo parashikohet në:</p> <p>-VKM Nr.617, datë 22.09.2022 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfuturimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar p ër ndihmë ekonomike", të ndryshuar, kategoria "jetimet që nuk janë në institucione" përfiton ndihmë ekonomike në masën 9900 lekë në muaj.</p> <p>Për muajin Prill 2023 kanë përfutur ndihmë ekonomike 886 jetimë që nuk janë në institucione.</p> <p>-VKM Nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfuturimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmë ekonomike", të ndryshuar, për të përfutur ndihmë ekonomike kjo kategori njafton të paraqesë pranë administratorit shoqëror në njësinë administrative ku jetojnë një kopje të kartës së identitetit dhe kopjen e noterizuar të statusit të jetimit.</p> <p>Nga ana tjetër, fëmijët pa kujdes prindëror, përfshirë dhe fëmijët jetim, sipas ligjit të sipërcituar, në pamundësi për të pasur kujdes në familjen biologjike, apo në një familje kujdestare, referohen në qendrat rezidenciale të përkujdesit shoqëror, duke respektuar procedurat e parashikuara në kuadrin rregullator të shërbimeve shoqërore.</p> <p>Gjithashtu ata që ndjekin arsimin bazë duhet të paraqesin dhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës, të lëshuar nga shkolla, për të përfutur pagesën shtesë si dhe për jetimet që vaksinohen, duhet të paraqesin fotokopje të librit të vaksinave sipas kalendarit të detyrueshëm për grupmoshat e fëmijëve për të përfutur pagesën shtesë.</p> <p>Në rast se një familje e cila trajtohet me ndihmë ekonomike qëllon që humb njërin nga prindërit (nënën ose babain), ndihma ekonomike nuk humbet nëse një i mitur përfiton pension familjar të nënës ose babait, por është e detyrueshme të deklarohet si e ardhur në momentin e aplikimit për ndihmë ekonomike ose gjatë deklarimit 3 mujor bazuar në Ligjin 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Pyetjet 8 & 10 do t'i kalojnë për trajtimin Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke ju vendosur në dëgjim, si dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi çështjet e pensioneve lidhen me parashikimet e bëra në ligjin e sigurimeve shoqërore.; Informacion prej Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë se në mbështetje të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, "Pensionet familjare" Neni 40 "Kushtet e përfuturimit Personat që janë në ngarkim të personit që vdes, i cili kishte kushte për përfuturimin e njërit nga llojet e pensioneve ose merrte pension, kanë të drejtë të marrin pension familjar; Pension familjar përfutrojnë: c) Jetimi kur provohet që ai ishte në ngarkim të atij që vdiq dhe ka një moshë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, nëse studion ose është i paafte për punë, para se të arrijë moshat e mësipërme;</p> <p>d) Njërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të. Në një rast të tillë ata trajtohen si jetimë.</p> <p>Pensionin familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit. Pensioni familjar jepet në masën:</p> <p>a) 50 përqind për personin e ve dhe b) 25 përqind për çdo jetim ose persona të tjerë që përfutrojnë.</p> <p>Kur nuk merret pension i parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni, masa e pensionit për jetimin është 50 përqind, kur ai është ose mbetet vetëm pjestar në pension.</p> <p>Kur pjestarët në pension janë më shumë se një jetim, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25 përqind.</p> <p>Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes.</p> <p>2. Jetimi ka të drejtën e një pensioni familjar edhe nëqoftëse prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij. Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25 përqind e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50 përqind e tij. 3. Jetimi që humbet të dy prindërit, do të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre.Ndërsa përta i pëket pakës 10 kjo nuk ka lidhje me sigurimet shoqërore, vetëm nëse është në kushtet e përfuturimit të pensionit familjar, si në sipër.</p>	E plotë; E deleguar
37	29.05.2023	15.06.2023	<p>Informacion nëse ka një informacion zyrtar të botuar për realizimin e treguesve të performancës gjatë periudhës së zbatimit të secilës prej 4 kontratave konkencionare të llojit parteneritet publik privat që zotëron institucioni juaj</p>	<p>Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale raporton në mënyrë të detajuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me raporte 1 mujore, 3 mujore, 6 mujore dhe 1 vjeçare sipas kërkesave, ligjeve, dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.</p>	E plotë
38	29.05.2023	12.06.2023	<p>Informacion për listë barnash të caktuara</p>	<p>Përcjellë për kompetencë dhe trajtimin Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.</p>	E deleguar

39	01.06.2023	13.06.2023	<p>Informacion për numër personash me autizëm në Republikën e Shqipërisë; çfarë parashikon ligji për përkujdesjen e personave autikë; numri i qendrave shëtitore dhe private për përkujdesjen e personave autikë në Republikën e Shqipërisë; deri në çfarë moshe qëndrojnë personat autikë në këto qendra; nëse ka qendra në të cilat kjo kategori të qendrojë si rezident (për 24 orë) në rastet e braktisjes, largimit nga jeta të të afërmeve, nëse po ku ndodhen qendra të tilla</p>	<p>Informacion se sipas të dhënave që disponojmë numri i personave me çrregullime të spektrit autik të regjistruar si përfutues nga skema e pagesës së aftësisë së kufizuar është 2, 214. Në linkun https://www.sherbimisocial.gov.al/institucione-perkujdesje/legjislacioni/legjislacioni-2 është i publikuar gjithë legjislacioni për fushën e aftësisë së kufizuar, që përfshin grupmoshat për të rritur dhe fëmijët, i cili gjithashtu është i botuar në Fletore Zyrtare.</p> <p>Si më lart sipërcikuar, rregullat për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror janë përcaktuar me Ligjin Nr.121/2016, datë 24.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", rregulla të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Ky ligj përcakton llojet e përfutimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përbushin kushtet për të përfutur, si dhe procedurat e kërimit e të përfutimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror.</p> <p>Subjektet që gëzojnë të drejtën e përdorimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë përcaktuar në nenin 5 e vijues të Ligjit Nr.121/2016, datë 24.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Shërbimet e kujdesit shoqëror dhe mënyrat e ofrimit të tyre përcaktohen në nenin 8 e vijues të Ligjit Nr.121/2016, datë 24.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Për sa i përket kujdesit shëndetësor, kuadri ligjor në fuqi në këtë fushë siguron ofrimin e kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet e ofrimit të tij. Në kujdesin shëndetësor parësor , ndiqet zhvillimi i fëmijës nga ekipet e konsultorit të nënës dhe fëmijës, sipas protokolleve të dedikuara, të cilat janë përditësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vitin e kaluar. Gjithashtu për një trajtim më të specializuar mjeku i familjes referon fëmijën pranë QKSHM, Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, ku pacientit trajtohet nga ekipet multidisiplinare.</p> <p>Në rastet e vështira të diagnozave shumëfisha hialka e fundit referenese për trajtim dhe diagnostifikim është në nivel terciar pranë Klinikës së Psikiatrisë për Fëmijët dhe Adoleshentët në QSUNT.</p> <p>Në lidhje me shërbimet publike, përfshirë dhe qendrat e zhvillimit ku marrin shërbim fëmijët me çrregullime të spektrit autik, që financohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe janë në administrim të Shërbimit Social Shtetëror, ju mund të konsultoni webinlun https://www.sherbimisocial.gov.al/institucione-perkujdesje/.</p> <p>Në Qendrat e Zhvillimit përfutuesit janë të grupmoshës nga 6-21 vjeç. Në këto qendra nuk ka raste të fëmijëve autikë të braktisur. Në lidhje me qendrat private për përkujdesjen e personave autikë, sqarojmë se referuar shtojcës X.1 të Ligjit Nr.10081, datë 23.02.2009 "Për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ato janë veprimtari private të cilat bëjnë pjesë në nënkategorinë "Shërbime të përkujdesit komunitar", veprimtari e cila shqyrohet dhe licencohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit.</p>	E plotë
40	01.06.2023	15.06.2023	<p>Informacion se në çfarë faze janë punimet për ndërtimin e spitalit të sëmundjeve të brendshme në korpusin spitalor të Traumës; kur pritet të hapet dhe të jetë funksional ky spital; sa është vlera e investimit për ndërtimin e spitalit të sëmundjeve të brendshme në korpusin spitalor të traumës;sa është kapaciteti i këtij spitali</p>	<p>Informacion se kanë përfunduar punimet për rikonstrukcionin e Godinës tre katëshe të Sëmundjeve të Brendshme dhe Ndërtimit të Urës Lidhëse me Korpusin Qendror në Spitalin Universitar të Traumës. Vlera e këtij investimi është 338,677,629 lekë me TVSH.Shërbimi i Sëmundjeve të Brendshme Nr.1 dhe Nr.2 si dhe Konsultat pranë këtij spitali do të vijojnë funksionimin menjëherë pas përfundimit të procesit të transferimit të shërbimeve.Sa i përket kapacitetit, Shërbimi i Sëmundjeve të Brendshme Nr.1 dhe Nr.2 ka një kapacitet prej rreth 60 shtrerësh.</p>	E plotë
41	02.06.2023	27.06.2023	<p>Informacion sa zile për moshat e treta janë publike në kryeqytet; vendodhja për secilin azil publik/sa azile për moshat e treta janë private në kryeqytet; vendodhja për secilin azil privat;sa është fondi për secilin nga këto azile</p>	<p>Informacion se në bashkinë Tiranë i vetmi institucion publik i përkujdesit për të moshuar është "Shtëpia e të Moshuarve" me vendodhje Rruga "Deli Ndreu", Lagja "Ali Demi", Tiranë.Në lidhje me pikat tuaja të kërkesës për sa i përket shtëpije të të moshuarve private ju referojmë të dhënat e kontaktit të publikuara në beblinlun zyrtar të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore https://inspektoratipunes.gov.al/kontakti-inspektoratit/ me qëllim marrjen e informacionit të mëtejshëm nga ana juaj.</p>	E plotë
42	03.06.2023	15.06.2023	<p>Informacion ku mund të drejtohet për aplikime paraqitur për në spitale shtetërore për anestezi-reamimator</p>	<p>Informacion për mundësinë e interesimit pranë Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor për aplikimin e paraqitur, në kontaktet si vijon:Adresa "Rruga e Dibrës", Nr 12, Godina Biomedical, Tiranë; E-mail: jona.mustafaraj@oshksh.gov.al.</p>	E plotë
43	08.06.2023	08.06.2023	<p>Informacion mbi procedurën IVF falas në martentitetin "Koço Gëlozheni"</p>	<p>Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është në proces e sipër të punës për finalizimin e procedurave komplekse në realizimin në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gëlozheni". Shumë shpejt kjo procedurë do të zhvillohet falas, por ende nuk është aktive.</p>	E plotë
44	09.06.2023	14.06.2023	<p>Informacion se cilat janë masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me rekomandimet e dhëna nga Avokati i Popullit më datë 21.05.2014, nëse është miratuar një protokoll për trajtimin e pacientëve me Hipertermi Malinje, gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, vendosje në dispozicion një kopje të protokollit të miratuar</p>	<p>Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk mund t'ju paraqesë dokumentacionin arkivor për të cilin kërkohet informacion, pasi për një periudhë të pacaktuar kohore regjistrat e protokollit të këtij viti i janë përcjellë për arsye hetimore organit të prokurorisë. Në vijim të këtij fakti, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i është drejtuar me shkrësë me objekt "Kërkesë për Informacion" institucionit të Avokatit të Popullit për të na vendosur në dispozicion këtë korrespondencë midis dy institucioneve tona. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është në pritje të kthimit të përgjigjes nga ky institucion.</p>	E plotë
45	12.06.2023	15.06.2023	<p>Informacion se cila është skema e rimborsimit që përfitojnë pacientët e dializës, sa është shuma që përfitojnë këta pacientë, në bazë të cilit ligj mbështetet rimborsimi, në cilat kushte e përfitojnë autoambulancën pacientët e dializës.</p>	<p>Informacion se fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor ushtron veprimtarinë e tij në zbatim dhe në përputhje të Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në nenin 10 të këtij ligji parashikohet se sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, në spitalin publik dhe jo-publik për personat e siguruar. Fondi financon dhenësit e shërbimit shëndetësor spitalor për paketat e shërbimeve shëndetësore spitalore, të ofruara prej tyre në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023".</p> <p>Për sa më sipër, rimborsimi i koston së transportit për pacientët që kryejnë hemodializë në qendrat e hemodializës të kontraktuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor bëhet sipas urdhrë të ministrit të shëndetësisë nr. 469, datë 30.08.2010 "Për sigurimin e transportit për të sëmurët që trajtohen me dializë", i ndryshuar me urdhrin e ministrit të shëndetësisë nr. 88, datë 20.02.2015, ku citohet: Drejtorja e spitalit në rastin e transportit me automjetet e transportit të shërbimit (autobus-furgon), të rimborsojë koston e transportit nga banesa në qendrën e dializës dhe anasjelltas, në masën e tarifave të përcaktuara për funksionimin e shërbimit urban publik, bazuar në biletat e paraqitura ose vërtetimin e lëshuar nga qendra përkatëse e dializës për numrin e seanceve të kryera nga secili i sëmurë i rrethit të tyre.Në kuptim të kësaj dispozite, drejtorja e shërbimeve spitalore rimborsojnë koston e transportit sipas tarifave të shërbimit urban publik, të përcaktuara nga institucionet kompetente sipas akteve nënligjore përkatëse të ministrisë së linjës. Të gjithë pacientët me hemodializë trajtohen me pagesë për stak të aftësisë së kufizuar dhe pagesë për ndihmë personale kur vlerësohet nga komisioni, në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij përkatësisht VKM Nr.722/2019 e ndryshuar dhe VKM Nr.182/2020 e ndryshuar .</p>	E plotë

46	13.06.2023	15.06.2023	Informacion si mund të kontaktoj me operatorët pasi kam dorëzuar dosjen për një pozicion pune si infermiere; nëse është e mundur të shqyrtohet kërkesa ime pasi jam një e re e plotësuar me bachelor-master-licencë	Informacion për mundësinë e interesimit pranë Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor për aplikimin e paraqitur, në kontaktet si vijon: Adresa "Rruga e Dibrës", Nr 12. Godina Biomedical, Tiranë; Email: jona.mustafafaraj@oshksh.gov.al	E plotë
47	14.06.2023	12.07.2023	Informacion sa është numri i fëmijëve jetim në Shqipëri; sa është numri i fëmijëve jetim të cilët nuk kanë nënënsa është numri i fëmijëve jetim të cilët nuk kanë babain;sa është numri i fëmijëve jetim të cilët nuk kanë të dy prindërit; sa është numri i fëmijëve në Shqipëri të cilët janë me status jetimi; cili është menyra sesi një fëmijë e fiton statusin e fëmijës jetim;cila është ndihma që parashikon Ministria e Mbrojtjes Sociale për këtë kategori; si përcaktohen shumat në para që marr një fëmijë jetim, pas vdekjes së njërit prej prindërve (pensioni që marrin deri në 18 vjeç); në rast se një familje e cila trajtohet me ndihmë ekonomike qëllon që humb njërin nga prindërit (nënen ose babain) dhe fëmijët fillojnë dhe trajtohen me pensionin e babait ose nënës, a e humb të drejtën e ndihmës ekonomike;nëse një fëmijë humb nënen, a përfiton ai ndihmë nga shteti- nëse po si	Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk disponon të dhëna mbi numrin e fëmijëve jetim në Shqipëri, pasi në bazë të Ligjit Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit", i ndryshuar, disponohen të dhëna për ata fëmijë që aplikojnë për të përfutur status in, i cili përfitohet bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 1, të Ligjit Nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit", i ndryshuar, duke aplikuar për marrjen e statusit pranë Shërbimit Social Shtetëror. Konkretisht përfitojnë statusin e jetimit personat me moshë 0-25 vjeç, që kanë kaluar ose jo nëpër institucione shtetërore a private të përkujdesit shoqëror dhe që plotësojnë këto kritere:"1. Të lindurit jashtë martesë.2. Nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit.3. Të cilëve me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton më.4. Që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre". Të dhënat që disponojnë lidhur me numrin e fëmijëve që trajtohen me status jetimi dhe konkretisht numri i fëmijëve që trajtohen me këtë status dhe nuk kanë gjallë asnjë nga prindërit është 267 persona, numri i fëmijëve të cilët janë me status jetimi është 888 persona, nga të cilët 845 janë të grupmoshës 0-18 vjeç dhe 43 prej tyre janë të grupmoshës 18-25 vjeç. Lidhur me ndihmën që jepet për fëmijët me status jetim, ajo parashikohet në: -VKM Nr.617, datë 22.09.2022 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfuturimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar p ër ndihmën ekonomike", të ndryshuar, kategoria "jetimet që nuk janë në institucione" përfiton ndihmë ekonomike në masën 9900 lekë në muaj. Për muajin Prill 2023 kanë përfutur ndihmë ekonomike 886 jetimë që nuk janë në institucione. -VKM Nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfuturimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar, për të përfutur ndihmë ekonomike kjo kategori mjafton të paraqesë pranë administratorit shoqëror në njësi administrative ku jetojnë një kopje të kartës së identitetit dhe kopjen e noterizuar të statusit të jetimit. Nga ana tjetër, fëmijët pa kujdes prindëror, përfshirë dhe fëmijët jetim, sipas ligjit të sipërcituar, në pamundësi për të pasur kujdes në familjen biologjike, apo në një familje kujdestare, referohen në qendrat rezidenciale të përkujdesit shoqëror, duke respektuar procedurat e parashikuara në k udadrin rregullator të shërbimeve shoqërore. Gjithashtu ata që ndjekin arsimin bazë duhet të paraqesin dhe vërtetimin për ndjekjen e shkollës, të lëshuar nga shkoila, për të përfutur pagesën shtesë si dhe për jetimet që vaksinohen, duhet të paraqesin fotokopje të librit të vaksinave sipas kalendarit të detyrueshëm për grupmoshat e fëmijëve për të përfutur pagesën shtesë. Në rast se një familje e cila trajtohet me ndihmë ekonomike qëllon që humb njërin nga prindërit (nënen ose babain), ndihma ekono mike nuk humbet nëse një i mitur përfiton pension familjar të nënës ose babait, por është e detyrueshme të deklarohet si e ardhur në momentin e aplikimit për ndihmë ekonomike ose gjatë deklarimit 3 mujor bazuar në Ligjin 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë". Pyetjet 8 & 10 do t'i kalojnë për trajtim Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke ju vendosur në dijeni, si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pasi çështjet e pensioneve lidhen me parashikimet e bëra në ligjin e sigurimeve shoqërore. Përcjellë për kompetencë dhe trajtim pika 8 dhe 10 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Insitutit të Sigurimeve Shoqërore.	E plotë; E deleguar
48	15.06.2023	30.06.2023	Informacion mbi arsyet që nuk është bërë aplikim nga MSHMS për futjen e barnave mjekësore L-Asparaginase dhe Crisantaspase për fëmijët e sëmurë me leucemi; për shpalljen fitues nga MSHMS kompani private kur nuk kanë patur licencim të barnës mjekësore L-Asparaginase në vendin tonë	Informacion se Ligji Nr. 105/2014, datë 22.12.2022 "Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik", i ndryshuar, parashikon: Neni 11 "Autorizimi i tregtimit"; "1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregtim nga Agjencia. 2. Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave." Neni 12 "Aplikimi dhe praktika e dhënies së autorizimit të tregtimit"; "1. Aplikimi dhe praktika e dhënies së autorizimit të tregtimit kryhen pranë Agjencisë nga prodhuesit vendas të licencuar, mbajtësi i autorizimit për tregtim, edhe kur ky nuk është prodhues i barit, sipas rregullave të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave." Gjatë vitit 2022, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, ka propozuar prokurimin e barit "Crisantaspase" si alternativë e barit "L-Asparaginase". Rrjedhimisht, me shkresën Nr. 1677/1 Prot., datë 12.04.2022 me objekt "Mbi prokurimin e barit Crisantaspase", Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i ka deleguar të drejtën e prokurimit të barit "Crisantaspase" Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, si autoriteti i vetëm kontraktor, i cili ka kërkuar prokurimin e tij.	E plotë
49	15.06.2023	10.07.2023	Informacion/ankesë për bërje analizash si dhe marrje të kempit si person i sëmurë	Informacion se referuar informacionit të siguruar prej Shërbimit Social Shtetëror, për komisionimin përkatës nga KMCAp më datë të caktuar me vendimin përkatës nga i cili është përfutur gjatë datave përkatëse me diagnozë të caktuar si dhe informacion se ku mund të bëhen analizat laboratorike.	E plotë
50	19.06.2023	23.06.2023	Informacion sa e rrezikuar është popullata nga konsumimi i pijeve alkoolike që prodhohen në mënyrë ilegale, të palicencuar; cila është fasha e moshave që është në rrezikuar që sjell konsumi i pijeve alkoolike të prodhuara në mënyrë ilegale; në kushtet kur tregtimi i pijeve alkoolike të prodhuara në mënyrë artizanale është masiv masat e marra prej institucionit për të ndërgjegjësuar popullatën; si ka qenë bashkëpunimi me institucionet e tjera si AKU apo inspektoratet për të kontrolluar dhe frenuar tregtimin e këtyre pajisjeve	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Institutit të Shëndetit Publik.	E deleguar

51	19.06.2023	23.06.2023	Informacion për kërkesë për pajisje me vërtetim që tregon se në Shqipëri nuk jepej licencë për të ushtruar profesionin e punës sociale në periudhën e vitit 2018 kur jam diplomuar në degën punë sociale pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës	Informacion se me Ligjin Nr. 163/2014, datë 4.12.2014 "Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë", u krijua Urdhri i Punonjës Social, i cili jep të drejtën e ushtrimit individual të profesionit të punonjësit social nëpërmjet dhënies së licencës profesionale. Urdhri i Punonjës Social vijon të ushtrroj veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin Nr.163/2014"Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.Rrjedhimisht kërkesa juaj për pajisjen me dokumentin vërtetim të mos lëshimit të licencës për ushtrimin e profesionit të punonjësit social në periudhën e vitit 2018, d uhet të adresohet pranë këtij organi publik dhe jo Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Të dhënat e kontaktit të Urdhrit të Punonjësve Socialë gjenden të publikuara në linkun https://urdhripunonjessociale.al/kontakti/ .	E plotë
52	19.06.2023	22.06.2023	Informacion dhe kërkesë për vendosje në dispozicion të dhënash për procedurë prokurimi si: kopje të urdhrin të prokurimit, kopje të dokumentacionit në lidhje me analizën e tregut për përcaktimin e fondit limit, kopje të urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, kopje të raportit të vlerësimit dhe kopje të raportit përmbledhës të komisionit të vlerësimit të ofertave, kopje të ofertës së fituesit të kontratës, kopje të kontratës së nënshkruar me fituesin e procedurës së prokurimit, kopje të faturave dhe pagesat e kryera, kopje të vërtetimit të realizimit me sukses të procedurës së prokurimit	Informacion për procedurën e prokurimit se është një procedurë e zhvilluar me mjete elektronike në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al dhe për rrjedhojë informacioni mbi të është i aksesueshëm nga çdo person i interesuar. Sa më lart bashkëlidhur kesaj shkresë do të gjeni Formularin e Njoffimit të Fituesit për procedurën e sipërpërmendur dhe Buletin Nr.139, datë 10 tetor 2022, ku mund të gjeni informacionin e kërkuar.	E plotë
53	19.06.2023	23.06.2023	Informacion sa e rrezikuar është popullata nga konsumimi i pijeve alkoolike që prodhohen në mënyrë ilegale, të palicensuar; cila është fasha e moshave që është në e rrezikuar që sjell konsumi i pijeve alkoolike të prodhuara në mënyrë ilegale; në kushtet kur tregtimi i pijeve alkoolike të prodhuara në mënyrë artizanale është masiv, masat e marra për të ndërgjegjësuar popullatën; si ka qenë bashkëpunimi me institucionet e tjera si Agjencia Kombëtare e Ushqimit apo inspektoriatet për të kontrolluar dhe frenuar tregtimin e këtyre pijeve	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Instituti të Shëndetit Publik.	E deleguar
54	20.06.2023	23.06.2023	Informacion për pjesëmarrje në event	Informacion për personin e kontaktit që do të marrë pjesë në event	E plotë
55	20.06.2023	11.07.2023; 19.07.2023	Informacion për vendosjen në dispozicion të numrit të spitalëve të specializuar për kurim të personave me probleme të shëndetit mendor; numrin e shtrretëve në këto spitale; numri aktual i pacientëve; numri i personelit për secilin prej këtyre spitalëve; numër mjekësh, numër infermierësh etj; vlera e buxhetit që Ministria e Shëndetësisë jep në vit për secilin prej këtyre spitalëve; nëse ka një shifër Ministria e Shëndetësisë në lidhje me numrin e popullatës të cilët vuajnë nga sëmundje të shëndetit mendor; vendosje në dispozicion të numrit të personave të cilët janë shtruar për secilin prej këtyre spitalëve gjatë 10 viteve të fundit.	Informacion per shërbimin e shëndetit mendor me shtrretë ofrohet në katër spitale/shërbime psikiatrike, përkatësisht në Spitalin Psikiatrik Elbasan, Spitalin Psikiatrik Vlorë, Shërbimi i Shëndetit Mendor me shtrretë në Shkodër dhe Shërbimi Psikiatrik pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë. Në total numri i shtrretëve në këto 4 shërbime është 600, përkatësisht: 310 shtrretë në Spitalin Psikiatrik Elbasan, 165 shtrretë në Spitalin Psikiatrik Vlorë; 35 shtrretë në Shërbimin e Shëndetit Mendor me shtrretë Shkodër, 90 shtrretë në Shërbimin Psikiatrik pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë. Shërbim i specializuar në shëndet mendor ofrohet edhe në nivel komunitar pranë 10 Qendrave Komunitare të Shëndetit Mendor (shërbime ambulatorie multidisiplinare nga një staf i përbërë nga mjekë psikiatër, psikolog, punonjës socialë, infermierë, etj.). Ndërkohë pranë 14 Shtëpive Mbështetëse ofrohet shërbim rehabilitues multidisiplinar, në një ambient sa më të ngjashëm me atë familjar, për rreth 140 persona me çrregullime kronike (serioze) të shëndetit mendor (kryesisht ish rezidentë kronikë të spitalëve psikiatrike), ku qëllimi kryesor është përkujdesja dhe rehabilitimi i tyre. Për sa i përket ofrimit të shërbimeve me shtrretë, janë realizuar 3 115 shtrime pranë shërbimeve të shëndetit mendor të specializuar me shtrretë për vitin 2022. Në lidhje me pikën 4, 5 dhe 7 ato përcillen për trajtim dhe kompetencë Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor si dhe Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë; Referuar informacionit të përcjellë prej Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor. Numri i personelit në Spitalet Psikiatrike përkatësisht Elbasan dhe Vlorë që janë në varësi të Drejtorive Rajonale të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor është: Spitali Psikiatrik Elbasan :Mjek Psikiatër 7, Infermier 68, Stomatolog 1,Farmacist 2,Kujdestar 43,Terapist Okupacional 4,Punonjës Pastrimi 39, Psikolog 7, Punonjës Social 4, Administrata 18, Totali 193. Spitali Psikiatrik Vlorë: Mjek Psikiatër 7, Infermier 41, Stomatolog 1, Farmacist 1, Kujdestar 30, Psikolog 5, Punonjës Social 9, Laborant 1, Administrata 34, Totali 129 Numri i personave të shtruar pranë Spitalëve Psikiatrike përkatësisht Elbasan dhe Vlorë gjatë 10 viteve të fundit është: Spitali Psikiatrik Elbasan -Viti 2013 564 -Viti 2014 431 -Viti 2015 405 -Viti 2016 479 -Viti 2017 468 -Viti 2018 503 -Viti 2019 450 -Viti 2020 190 -Viti 2021 252 -Viti 2022 340 -Viti 2023(6-mujori i parë) 208 Spitali Psikiatrik Vlorë -Viti 2013 470 -Viti 2014 512 -Viti 2015 646 -Viti 2016 493 -Viti 2017 500 -Viti 2018 496 -Viti 2019 481 -Viti 2020 400 -Viti 2021 368 -Viti 2022 481 -Viti 2023(6-mujori i parë) 242 Për sa i përket buxhetit të dhënë prej Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale çdo vit, ju mund të konsultoni linkun në faqen zyrtare të publikuar https://shendetesia.gov.al/tablet-e-raportimit-per-intervale-kohore-3-muaj-9-muaj-dhe-vjetore-si-dhe-relacionet-perkatese/ ku jepet informacion në lidhje me trajtimin e pacientëve në spitalet psikiatrike ndër vite.	E plotë; E deleguar; E plotë

56	21.06.2023	29.06.2023	Informacion për datën e fillimit të aplikimit në vendet vakante për psikologë në Qendra Shëndetësore	Përcjellë për kompetencë dhe trajnim Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.	E deleguar
57	22.06.2023	29.06.2023	Informacion mbi arsyet përse nuk është bërë aplikim nga MSHMS për futjen e barnave mjekësore L-Asparaginase dhe Crisantaspase për fëmijët e sëmurë me leucemi:si janë shpallur fitues nga MSHMS kompani private kur nuk kanë patur licencim të barnës mjekësore L-Asparaginase në vendin tonë	Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e Organit Qendror Blerës, ka realizuar procedurën e prokurimit për barin "L-Asparaginase" në vitin 2017 (Loti 12 i B2/ REF 87.17.02.2017) dhe nëpërmjet marrëveshjes kuadër në vitin 2018 (Loti 13 REF-44462-02-06-2018 i B3 /REF-44432- 02-06-2018). Në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në Dokumentat Standarde të Tenderit në këto dy vite, janë shpallur fitues operatorët ekonomikë, të cilin kanë përmbyshur këto kritere. a. Sa i përket kriterit të veçantë të kualifikimit (KVK) në DST për licencimin, është kërkuar si më poshtë: "- Licencë e lëshuar nga QKL ose QKB për tregtim me shumicë të barnave". b.Sa i takon autorizimit për tregtim në Republikën e Shqipërisë është kërkuar: "5. Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofrohet duhet: - të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, /ose/ - të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre, /ose/ - të jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë: - Deklaratë me anën e të cilit të konfirmohet se bari që ofron është i pajisur me autorizim tregtimi dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme ose që disponon autorizim tregtimi nga FDA ose EMA. Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin e tregtimit; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, ueb-site); Data e lëshimit të autorizimit të tregtimit të barit që ofron, (pranë këtij institucioni) dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi." Për vitet e tjera, prokurimi i "L-Asparaginase", është realizuar nga vetë AK kërkuar të tij. (QSUNT). Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", gjatë vitit 2022, ka propozuar prokurimin e barit "Crisantaspase" si alternativë e barit "L-Asparaginase". Si rrjedhojë, për vitin 2022, me shkresën Nr. 1677/1 Prot., datë 12.04.2022 me objekt "Mbi prokurimin e barit Crisantaspase", QSUNT, si autoritet i vetem kontraktor, i cili ka kërkuar prokurimin e tij.	E plotë
58	23.06.2023	04.07.2023	Informacion në lidhje me mundësitë që ofrohen për llojin e I60G60 biznesit në fushën e artizanatit	Përcjellë për kompetencë dhe trajnim Ministrisë së Kulturës.	E deleguar
59	23.06.2023	04.07.2023	Informacion për marrje vërtetimi për moslëshim licence të punonjësit social gjatë vitit 2018	Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka realizuar procesin e regjistrimit, gjatë vitit 2016 dhe vitit 2021, të punonjësve socialë, vetëm për efekt të realizimit të procesit të ngritjes së Urdhrit të Punonjësit Social dhe jo për të marrë licencë ushtrimi profesionali. Në të tilla kushte pranë MSHMS-së janë dorëzuar dokumenta fotokopje, jo origjinale, që nuk kanë asnjë lloj vlefshmërie për t'u pajisur me licensë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk jep vërtetime për licensë punonjësi social. Për t'u pajisur me licensë ju duhet të drejtoheni pranë Urdhrit të Punonjësit Social, sikundër ju kemi informuar më datë 23.06.2023.	E plotë
60	23.06.2023	25.07.2023	Informacion sa shqetësues është përdorimi i pijeve alkoolike të pakontrolluara; çfarë pasojash shëndetësore kanë ato për konsumatorët; sa është numri i personave të trajtuar në shkallë vendi nga shërbimi spitalor për shkak të intoksikimit nga alkooli gjatë këtij viti; sa % e personave të intoksikuar nga alkooli ju pëkasin të miturve dhe grupmoshave të reja; çfarë politikash zbaton Ministria e Shëndetësisë për të reduktuar konsumin e alkoolit	Informacion se konsumi i alkoolit është një fenomen i shtrirë gjerësisht në botë, por ka ndryshime të konsiderueshme mes dhe brenda shteteve lidhur me konsumin e tij, në varësi të praktikave shoqërore dhe kulturore në shumë pjesë të botës. Konsumi i alkoolit është pjesë e kulturës njerëzore dhe që reflekton mënyrën tonë të socializimit, të krenarit dhe të ndjerit të momenteve të rëndësishme të jetës, etj. Shumë njerëz e konsumojnë alkoolin arsyeshëm dhe shëndetshëm, ndërkohë që pirja e shpeshtë dhe sasiore e tij janë faktorë morbozietit të shtuar (si sëmundje kanceroze, hepatike, gastrointestinale, kardiake, neuro-cerebrale, etj.) dhe mortalitetit të parakohshëm. Reduktimi i dëmëve shëndetësore të lidhura me abuzimin me alkoolin është një prioritet i shëndetit publik, mbasi ai rënditë ndër pesë faktorët kryesorë të rrezikut për aftësi të kufizuara nga sëmundjet dhe vdekjet në nivel global. Abuzimi i alkoolit, është edhe prioritet i sigurisë publike pasi ai mund të shkaktojë çekullibrim në marrëdhëniet ndërpersonale brenda familjes dhe rrethit shoqëror, si dhe në rritjen e mundësive për t'u bërë viktimë e krimi. Duke reduktuar aftësitë frenuese dhe duke rritur agresivitetin, alkooli mund të risë gjastat e kryerjes së akteve të viciozës dhe krimi apo sjelljeve anti-sociale. Abuzimi i alkoolit shkakton edhe kosto financiare, mbasi mund të ndikojë në uljen e performancës në punë, e produktivitetit, etj. Me qëllim reduktimit të konsumit të alkoolit, por edhe përdorimit dhe abuzimit me substancat në përgjithësi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e angazhuar si në zbatimin e ndërhyrjeve parandaluese, ashtu edhe për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e duhur të rasteve me abuzim dhe varësi nga alkooli. Ndërhyrjet e mësipërme, janë të parashikuara edhe në kuadrin strategjik në fushën e shëndetësisë nga Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021 – 2030 të Plani i Veprimit për Promocionin Shëndetësor 2022 – 2030 dhe Programi i Parandalimit të Kontrollit të Sëmundjeve Jo të Transmetueshme 2022 – 2030. Parashikimet e veçanta në këtë kuadër për këtë çështje, synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullsisë shqiptare, nëpërmjet promovimit të stilit të jetesës së shëndetshme, zgjerimit dhe fuqizimit të mjediseve aftësuese, fushatave promovuese për shëndetin, me fokus të veçantë shkollat, larg përdorimit dhe konsumit të dëmshëm të alkoolit. Gjithashtu rrëja e identifikimit të hershëm të abuzimit me alkoolin dhe problematikave shëndetësore të lidhura me të, me qëllim referimin për trajtimit të specializuara sipas nevojës, janë pjesë e Paketës së Kontrollit Mjekësor Bazë për shtetasit 35 - 70 vjeç. Pranë Shërbimit të Adiktologjisë dhe Toksikologjisë Klinike në QSUT, për vitin 2022 janë hospitalizuar 517 persona, nga të cilët 283 janë hospitalizuar nga urgjenca dhe 234 nga sistemi i referimit, asnjë rast i mitur. Rastet e të miturve me intoksikacion nga alkooli të trajtuar në këtë shërbim janë të izoluar dhe nuk përbëjnë fenomen.	E plotë

61	26.06.2023	10.07.2023	Informacion mbi akomodimin e shtetasve me masë mjekësore në IEVP Lezhë, godinën 4, 5 dhe në konkretisht mbipopullimin, pse nuk po trajtohen këta persona në përputhje me ligjin nr.44/2012 "Për Shëndetin Mendor" ; kur planifikon MSHMS të krijojë strukturën për trajtimin e kësaj kategorie të dënuarish	Informacion se çështja e përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore është trajtuar gjërësisht në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të lidhur në vitin 2021 midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore", dhe aneksit të saj "Planit të Përbashkët të Veprimit për Përmirësimin e Kushteve dhe Trajtimit të Personave me Çrregullime të Shëndetit Mendor me Masë Mjekësore", marrëveshje e cila shpreh angazhimin serioz dypalësisht për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve dhe trajtimit të këtyre personave, drejt standarteve ndërkombëtare në këtë fushë. Plani i përbashkët i veprimit parashikon aktivitetet për periudhën tranzitore deri në ngritjen e Institucionit Mjekësor të Posaçëm si dhe aktivitetet për ngritjen e institucionit të specializuar me qëllim ofrimin e një kujdesi terapeutik, human dhe të sigurt.Për sa i përket fazës tranzitore të trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore pranë ambienteve të Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është angazhuar në përmirësimin e shërbimit të specializuar psikiatrik në këtë institucion. MSHMS ka angazhuar tashmë 3 mjekë psikiatër me kohë të plotë, të punësuar aktualisht në Spitalin Rajonal të Lezhës, të cilët ofrojnë shërbime psikiatrike. Ndërkohë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka siguruar dhe vazhdon të sigurojë diagnostikimin (ekzaminime kliniko-biokimike, imazherike, konsultave të specializuara, etj.) dhe trajtimin e specializuar (ndërhyrje kirurgjikale, etj.) për problematika të ndryshme shëndetësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të akomoduar në Institutin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, nëpërmjet shërbimeve të Spitalit Rajonal Lezhë dhe strukturave të tjera spitalore universitare.Gjithashtu, sipas nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të akomoduar në Institutin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ofron ekzaminime laboratorike, depistime epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë në fushën e shëndetit publik, nëpërmjet Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor Lezhë dhe Institutit të Shëndetit Publik. Në lidhje me masat e marra për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje (ngritjen e Institucionit Mjekësor të Posaçëm), informojmë se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të kuartrit ligjor në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë, ka hartuar projekt-propozimin dhe dokumentin e veprimit për këtë qëllim, dhe ka aplikuar nëpërmjet Agjencisë së Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), për mbështetje financiare në kuadër të IPA III për ngritjen e këtij institucioni, duke e konsideruar si një nga projektet prioritare për sektorin e shëndetësisë. Gjithashtu, ky dokument veprimi është në përputhje dhe komplementar me veprimet e planifikuara në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030 dhe Planin e Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026 në fushën e shëndetit mendor.	E plotë
62	26.06.2023	21.07.2023	Informacion statistikor mbi konsumin e heparinës si substancë e tillë në spitale apo shërbime ku nevojitet pasi do ndihmonte për rezultate më reale studimin dhe aktivitetin në këtë fushë	Informacion se për informacionin statistikor mbi konsumin e heparinës si substancë në spitale apo shërbime, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale disponon informacion vetëm për sasitë e planifikuara nga vetë spitalet.Realizimi i nevojave të spitaleve është në bazë të marrëveshjeve kuadër dhe spitalet tërheqin sipas nevojave që kanë këto medikamente. Rrethimisht konsumi për këto barna është informacion që disponohet prej vetë spita leve.Informacioni për konsumin e tyre disponohet nga vetë spitalet, ku ju mund të adresoni kërkesën tuaj duke e paraqitur tek Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Spitali Universitar i Traumës, SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", SUOGJ "Koço Gilozen", Spitali "Memorial" Fier.	E plotë
63	29.06.2023	06.07.2023	Informacion/Kërkesë në gjuhë të huaj	Informacion se në zbatim të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", duhet të paraqitet kërkesa në gjuhën dhe shkrimin shqip.	E plotë
64	30.06.2023	11.07.2023; 14.07.2023	Informacion për numër azilësh për moshat e treta të cilat janë private në kryeqytet, vendodhja për secilin azil privat, sa është fondi për secilin nga këto azile dhe delegimi në institucionet përkatëse	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Informacion prej Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore se bazuar në Ligjin Nr.121/2016, datë 24.11.2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Neni 35, "Funksioni dhe kompetencat e Inspektoriatit", ISHPSHSH, nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, ka kompetencë të kontrollojë zbatimin e kriterëve, kushteve dhe standarteve të përkujdesit shoqëror në subjektet publike dhe jopublike, të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror sipas Ligjit Nr.121/2016, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Përfuttes të shërbimeve të përkujdesit shoqëror janë edhe të moshuarit, të cilët përfitojnë përkujdes social-shëndetësor në shtëpi të përkujdesit rezidencial për të moshuar. Standartet e përkujdesit të ofruar në këto "shtëpi", qofshin institucione publike apo jopublike, janë të miratuara me VKM Nr. 821 datë 06.12.2006 "Për miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për të moshuar në Institucionet Rezidenciale". Lidhur me pyetjet 1 dhe 2, për numrin e institucioneve publike të përkujdesit rezidencial për të moshuar në kryeqytet, dhe vendodhjen e tyre, ju informojmë se ka vetëm 1, (një) institucion publik rezidencial për të moshuar, i cili është "Shtëpia e të Moshuarve" Tiranë, me adresë:Rruga "Deli Ndreu", Lagja "Ali Demi" Tiranë.Lidhur me pyetjet 3 dhe 4, për numrin e institucioneve jopublike të përkujdesit rezidencial për të moshuar, në kryeqytet dhe vendodhjen e tyre, ju informojmë se janë të identifikuara dhe vlerësuara 11 të tilla. Këto shtëpi të moshuarish janë: 1. Shtëpia e të Moshuarve "Streh dhe Shpresë", Fondacioni Kuka; Rr. "Shefqet Kuka", Nr.31, Njësia Nr. 4 Tiranë. 2. Shtëpia e të Moshuarve, (meshku), e Fondacionit "Misionaret e Bamirësisë Motrat e Nënë Terezës"; me adresë Rruga "Kajo Karafil", Nr.42 Tiranë. 3. Qendër e Përkujdesit Rezidencial për Individë në Nevojë, (Femra), Fondacioni "Misionaret e Bamirësisë Motrat e Nënë Terezës"; Rruga "Irfan Tomina", Tiranë. 4. Klinika "Joshua Centre", Rruga "Ali Visha", Vila Nr.16 Tiranë. 5. Shtëpia e të Moshuarve "Rrezet e Jetës"; me vendndodhje: Rruga nacionale Tiranë-Elbasan, km3, Farkë, Tiranë. 6. Shtëpia e të Moshuarve "Vatër e Ngrohje"; Sauk i Vjetër Nr.40, Tiranë. 7. Shtëpia e të Moshuarve "Ruajtje Moshën"; Rruga "Mustafa Demiri", Vila nr.5, Tiranë. 8. Shtëpia e të Moshuarve "Duajtje Moshën"; Rruga "Tre Vëllezërit Kondi", (vilat Gjermane), Tiranë. 9. Qendra Rezidenciale "Shtëpia e Zotërinjëve"; Rruga dytësore Tiranë-Durrës, Fshati Kodër Bërxullë, Tiranë. 10. Qendra Rezidenciale "Vila e Luleve"; Rruga Vaqar 1, Vaqarr, Tiranë. 11. Qendra Rezidenciale për të Moshuar "Te Moza"; Sauk i Vjetër, Tiranë. Lidhur me pyetjen 5 ju sqarojmë se Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, pranë ISHPSH-së nuk ka kompetencën menaxhimin, alokimin dhe kontrollin të shpenzimeve financiare të institucioneve të përkujdesit shoqëror, përfshi edhe ato për të moshuarit.	E deleguar; E plotë
65	04.07.2023	13.07.2023	Informacion/Kërkesë në gjuhë të huaj	Informacion se në zbatim të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", duhet të paraqitet kërkesa në gjuhën dhe shkrimin shqip.	E plotë
66	05.07.2023	13.07.2023	Informacion/Kërkesë për statistikë se sa është numri i OIF aktive të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri dhe nëse ekziston një pasqyrë e buxheteve të tyre	Informacion se në linkun https://www.sherbimisocial.gov.al/ofj-2/ gjenden të publikuara organizatat jo fitimprurëse të cilat janë partnerë të rëndësishëm të Shërbimit Social Shtetëror.	E plotë

67	05.07.2023	13.07.2023	Informacion për punësim, pasi ka mbaruar shkollën për infermierin dhe ka diplomë licencë	Informacion se punësimi i personelit infermier dhe i teknikëve të tjerë të shkencave mjekësore bëhet nëpërmjet Portalit "Infermierë për Shqipërinë", bazuar në Udhëzimin nr. 481, datë 27.06.2019 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ju mund të vizitoni linkun http://infermierpershqiperine.al për tek Portalin "Infermierë për Shqipërinë" dhe vendet vakante të shpallura në këtë portal, si dhe për informacione të mëtejshme mund të interesoheni pranë Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor në kontaktet si vijon: Adresa "Rruga e Dibrës", Nr 12, Godina Biomedical, Tiranë; E-mail: jona.mustafaraj@oshksh.gov.al	E plotë
68	06.07.2023	06.07.2023	Informacion në lidhje me rastin e procedurës së desinsekitimit: I.Biocidi-AquaBac 200G dhe AquaBac DF 3000 nëse kanë marrë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë; Shtimi i këtyre dy biocideve nëse është i përfshirë në listën e VKM nr.933, datë 25.11.2020; si është ndjekur procedura dhe nga kush është miratuar autorizimi për këto dy biocide	Informacion se po, sipas legjislacionit në fuqi konkretisht, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg", Biocidi AquaBac 200G dhe Biocidi AquaBac DF 3000 janë pajisur nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë me autorizimin nr. 1 datë 17.01.2023 dhe me autorizimin nr. 2 datë 17.01.2023 Sa i përket shtimit të këtyre biocideve bëjmë me dije se lenda aktive Bacillus thuringiensis subsp. israelensis serotipi H14 është pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave si dhe bazuar dhe në verifikimet e kryera në faqen zyrtare të ECHA (Agjencia Evropiane e Kimikateve) këto produkte biocide janë të autorizuar edhe në vendet e BE si produkte me lëndë aktive Bacillus thuringiensis subsp. israelensis Serotipi H14, Shtimi AM 65 – 52.Verifikimi në faqen zyrtare të ECHA për të gjithë dosjet që aplikojnë për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide është një nga kriteret që duhet të përmbajë dosja e aplikimit bazuar në VKM nr. 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg, Kreu III "Përmbajtja e dosjes së aplikimit për autorizim" pika "dh" "të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4 të Nenit 8 të Ligjit nr. 95/2015 dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për Produktet Biocide të Autorizuara. Aplikimi është kryer në platformën e-Albania nga subjekti tregtar për biocidin AquaBac 200G me numër aplikimi MSHMS – 2022-4059169-WG në datën 10.12.2022 dhe për biocidin AquaBac DF 3000 me numër aplikimi MSHMS – 2022 – 8630889-TD në datën 10.12.2022. Bazuar në VKM nr. 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg" Kreu II "Procedura e dhënies së autorizimit të dhënies në treg të produkteve biocide" dosja me dokumentacionin Teknik pas vlerësimit nga sekretariati i dërgohet për vlerësim ekspertive të fushës pranë Institutit të Shëndetit Publik që ka përgjegjësinë për vlerësimin e produktit biocid bazuar në informacionin e paraqitur në dosje. ISHP ka përgatitur raportin e komisionit për vendosjen në treg të produktit biocid që e ka depozituar zyrtarisht pranë Sekretariatit. Sekretariati përgatit materialin përmbledhës për mbledhjen e vlerësimit të Autorizimit të Produkteve Biocide. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide në zbatim të pikës 9, Kreu II të VKM-së sipërcituar mbledhet, shqyrtton dosjen dhe rekomandon këshimin ose refuzimin e autorizimit për vendosjen në treg të produkteve biocide në zbatim të legjislacionit në fuqi.	E plotë
69	06.07.2023	25.07.2023	Informacion në lidhje me një shkrim me titull "Sëmundësitë HIV/AIDS: arsyeja pse analiza e ngarkesës virale nuk zhvillohet në laboratorin e QSUT, pasi ky shërbim u dha me koncension; sa është kostoja vjetore për të kryer një analizë të tillë për të gjithë personat e prekur nga HIV/AIDS; nëse ka ndjekur ndonjë politikë të veçantë rimbursimi Ministria e Shëndetësisë, për dy vitet që ky shërbim nuk u ofrua në sistemin publik, për të sëmurët me HIV/AIDS	Informacion se analiza e ngarkesës virale (HIV-ARN) realizohet pranë Institutit të Shëndetit Publik, pra brenda shërbimit publik shëndetësor. Në listën e ekzaminimeve të spitalave për shërbim laboratorik, bazuar në reformat nga strukturat shëndetësore, ka një numër të caktuar të analizave që ofrohen ku përfshihen edhe dy analiza mjaft të rëndësishme për sa i përket këtij infeksioni, për diagnostikimin dhe monitorimin e tij, që janë testi serologjik për HIV 1+2 dhe niveli i limfociteve CD4+. Kostoja vjetore e ekzaminimeve varion. Ajo është në varësi të frekuencës së realizimit të këtyre analizave, e cila përcaktohet nga protokollet klinike, përgjigja ndaj trajtimeve dhe rregullsia e pacientit në marrjen e tyre dhe gjykimet të klinikistit i cili trajton pacientin.	E plotë
70	07.07.2023	07.08.2023	Informacion në lidhje me memorandumin për bashkëpunim për ofrimin e shërbimeve shëndetësore ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës, për pagesat për marrjen e shërbimeve të hemodializës për shtetas kosovarë në Shqipëri, çfarë përfshin ky memorandum bashkëpunimi, nëse mund të kemi qasje në këtë memorandum; nëse është e përfshirë këtu çështja e shërbimeve për dializë për pacientët nga Kosova dhe nëse po, çka nënkupton ajo, nëse pas nënshkrimit, a do të nis zbatimi i saj dhe kur shumë pacientë me dializë nga Kosova janë ankuar se gjatë pushimeve në Shqipëri detyrohen të paguajnë 120 euro në datë për shërbimet e hemodializës, nëse është shqyrtuar deri më tani dhe nëse do të merren parasysh ankesat dhe kërkesat e pacientëve për largimin e kësaj kostoje; nëse ekziston marrëveshja mes Kosovës dhe Shqipërisë për pacientët që duan të kryejnë shërbime spitalore për hemodializë të mos paguajnë para, nëse ka një arsye që diçka e tillë nuk është reciproke edhe në Shqipëri dhe pacientëve kosovarë nuk po u mundësohet ky shërbim fals	Informacion se në Protokollin Shtesë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në Fushën e Shëndetësisë, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë, të sapo nënshkruar në korrik 2023, në ofrimin e shërbimeve shëndetësore nuk përfshihet çështja e shërbimeve për dializë për pacientët nga Kosova. Në këtë protokoll palët angazhohen për të: nxjerr: 1. Bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të Qendrës Spitalore Universitare në Tiranë dhe Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, 2. Bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri dhe Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, 3. Bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor në Shqipëri dhe Inspektoratit Qendror Shëndetësor të Kosovës.	E plotë
71	07.07.2023	17.07.2023	Informacion sa është numri total i përfutuesve nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2022, sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj; numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfutues nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2022; sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj; sa është numri total i përfutuesve të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2022; sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj; sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfutues të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2022; sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj; sa është numri total i personave të cilat janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2022; sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj; sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2022; sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj; informacion nëse keni ju të dhëna statistikore mbi përfshirjen e të rinjve në skemat e mbrojtjes sociale për vitin 2022 dhe nëse po sa % zenë të rinjtë në raport me numrin e përfutuesve në total nga skema e mbrojtjes sociale	Percjellë për kompetencë dhe trajtim Shërbimit Social Shtetëror; Informacion se numri total i përfutuesve nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2022 është 63,783 (familje NE dhe përfutues të kategorive të veçanta). Ndajen e përfutuesve në meshkuj dhe femra nuk e disponojmë si të dhënë. Shërbimi Social Shtetëror nuk disponon të dhëna lidhur me numrin e përfutuesve të ndihmës ekonomike të moshave 15-29 vjeç dhe ndajen gjinore. Numri total i përfutuesve të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2022 është 70,208 persona. Nuk disponohen të dhëna lidhur me gjininë e tyre dhe numrin e përfutuesve të moshës 15-29 vjeç. Numri total i përfutuesve të shërbimeve sociale janë 15,177 (përfshihen përfutues të të gjitha shërbimeve ditore, rezidenciale, publike dhe jopublike. Nga numri total i përfutuesve të shërbimeve sociale 8,805 janë femra. Nuk disponohen të dhëna lidhur me grupmoshën 15-29 vjeç. Sipas të dhënave të grumbulluara nga Shërbimi Social Shtetëror për vitin 2022 numri total i përfutuesve të shërbimeve sociale për të rinjtë është 1,708 ku grupmosha e përfshirë është 18-22 dhe mbi 22 vjeç. Nga ky total 1,028 janë përfutues femra. Nuk ka statistika zyrtare lidhur me përfshirjen e të rinjve nga skemat e mbrojtjes sociale për vitin 2022 dhe përqindjen e tyre.	E deleguar; E plotë

72	10.07.2023	20.07.2023	Informacion për prokurimin e "L-Asparaginase" kur nuk ka qenë e licencuar, si janë bërë tendera për një barnë, e cila nuk është e licencuar; autorizimi për rastin konkret	Informacion se ligji Nr. 105/2014, datë 22.12.2022 "Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik", i ndryshuar, parashikon: Neni 11 "Autorizimi i tregimit"; "1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregim nga Agjencia. 2. Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barna të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është bërë autorizim tregimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave." Ashtu sikurse ju kemi bërë me dije edhe në parë për këto dy barna është zbatuar VKM i përcaktuar sipas pikës 2 të nenit 11 të ligjit të sipërcituar.Gjatë vitit 2022, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, ka propozuar prokurimin e barit "Crisantaspace" si alternativë e barit "L-Asparaginase". Rrjedhimisht, me shkresën Nr. 1677/I Prot., datë 12.04.2022 me objekt "Mbi prokurimin e barit Crisantaspace", Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i ka deleguar të drejtën e prokurimit të barit "Crisantaspace" Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, si autoriteti i vetëm kontraktor, i cili ka kërkuar prokurimin e tij.	E plotë
73	10.07.2023	19.07.2023	Informacion për ambientet e brendshme të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" për një aksident në një prej ashensorëve të spitalit	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.	E deleguar
74	11.07.2023	07.08.2023	Informacion në lidhje me pagesat për marrjen e shërbimeve të hemodializës për shtetasit kosovarë në Shqipëri, pasi ka një marrëveshje ekzistuese mes Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë dhe asaj në Shqipëri për shërbimet e pacientëve me dializë, që parashihet shërbime falas në të dy vendet për këtë kategori të pacientëve, pacientët me dializë nga Shqipëria marrin shërbime falas në spitalet e Kosovës, ndërsa pacientët e Kosovës duhet të paguajnë 120 euro vetëm për një seancë të hemodializës në Shqipëri gjatë qëndrimit në bregdet.Në Ministrinë e Shëndetësisë në Kosovë kanë thënë se nuk është gjetur mirëkuptim nga autoritete në Shqipëri për këtë çështje; arsyet pse nuk ka pasur gatishmëri nga Shqipëria të zbatohet marrëveshja për këtë kategori të pacientëve nësejo siç respektohet në Kosovë, cila është arsyeja për këtë; çfarë vendimi ka për këtë çështje aktualisht	Informacion se në Protokollin Shtesë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në Fushën e Shëndetësisë, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë, të sapo nënshkruar në korrik 2023, në Ofrimin e Shërbimeve Shëndetësore nuk përfshihet çështja e shërbimeve për dializë për pacientët nga Kosova. Në këtë protokoll Palet angazhohen për të nxistur: 1. Bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të Qendrës Spitalore Universitare në Tiranë dhe Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës. 2. Bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri dhe Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale. 3. Bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor në Shqipëri dhe Inspektoratit Qendror Shëndetësor të Kosovës.	E plotë
75	14.07.2023	19.07.2023	Informacion për vendosje në dispozicion të numrit të spitaleve të specializuara për kurim të personave me probleme të shëndetit mendor; numrin e shtretëve në këto spitalet; numri aktual i pacientëve; numri i personelit për secilin prej këtyre spitaleve, ku të jepen në numër mjekësh, infermierësh, etj, sa është buxheti që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jep në vit për secilin prej këtyre spitaleve, nëse ka një shufër Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në lidhje me numrin e popullatës të cilët vuajnë nga sëmundje të shëndetit mendor, kërkesë për vendosje në dispozicion të numrit të personave të cilët janë të shtuar për secilin prej këtyre spitaleve gjatë 10 viteve të fundit	Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kthyer përgjigje më datë 11.07.2023 kërkesit nëpërmjet kom unikimit elektronik të citin e gjeni bashkëlidhur.	E plotë
76	17.07.2023	18.07.2023	Informacion/Kërkesë në gjubë të huaj	Informacion se në zbatim të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", duhet të paraqitet kërkesa në gjubë dhe shkrimin shqip.	E plotë
77	19.07.2023	25.07.2023	Informacion se cilat janë arsyet që nuk është lidhur kontrata e korrikut 2022 për tenderin për sigurimin e "Bortezomb" nga Ministria e Shëndetësisë;nga e sigurojnë pacientët këtë preparat kur QSUT-ja nuk ka asnjë kontratë aktive që mundëson falas këtë preparat	Informacion brenda rolit takues të autoritetit publik, se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e organit qendror blerës ka lidhur marrëveshje kuadër nr.prot.1533/152, datë 19.07.2022 për sigurimin e medikamentit "Bortezomb 3.5 mg Flakon".	E plotë
78	24.07.2023	28.07.2023	Informacion mbi arsyet që nuk është lidhur kontrata e korrikut 2022 (Lot 3 Bortezomb, REF-25075-04-14-2022) për Marrëveshjen Kuadër për sigurimin e "Bortezomb"; (Ligji i Prokurimit Publik kërkon publikimin e lidhjes së kontratës Marrëveshje Kuadër ose të Minikontratës së parë për këtë Marrëveshje Kuadër); në rast se është lidhur kontrata, pse nuk publikohet në Agjencinë e Prokurimit Publik; nga e sigurojnë pacientët këtë preparat (Bortezomb) kur QSUT-ja nuk ka asnjë kontratë të lidhur (e theksojmë kontratë të lidhur dhe jo të shpallur fituese) apo minikontratë të lidhur të publikuar në APP; çfarë masash ka marrë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për rastin konkret	Informacion brenda rolit të autoritetit publik, se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka lidhur marrëveshjen kuadër Nr. 1533/152 datë 19.07.2022 me afat 24 muaj për barin "Bortezomb 3.5 mg Flakon" dhe ka bërë dërgimin e dokumentacionit për lidhjen e kontratave për furnizimin me këtë bar pranë autoriteteteve kontraktore përfutuese me shkresën Nr. 1533/157 datë 21.07.2022. Rrjedhimisht theksojmë se kontratat nuk lidhen nga kjo ministri tr, por nga drejtoritë spitalore përfutuese.	E plotë

79	24.07.2023	23.08.2023	<p>Informacion, kërkesë për nga dy marrëveshje të nënshkuara: "Marrëveshje e skemave të ndërlidhjes për identifikimin elektronik të qyteteve të Ballkanit Perëndimor" dhe "Marrëveshje mbi kushtet për aksesin e lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor" më datë 21 dhjetor 2021 nga Kryeministrat e Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut në kuadër të Nismës së Ballkanit të Hapur si shprehje e vullnetit të palëve për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe mirëkuptimin e ndërsjellë, me qëllim për të kontribuar në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të investimeve dhe punësimit në Ballkanin Perëndimor, për zbatimin e aktit "Marrëveshje mbi kushtet për aksesin e lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor", informacione si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -kopje të marrëveshjes në gjuhën shqipe; -datën e ratifikimit nga qeveria e Shqipërisë dhe numrin e aktit; -dokumentin/aktin për ngritjen e "Komitetit të Përbashkët" me detyrë organizimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të aktiviteve të parashkuara (sipas parashikimit të nenit 11 dhe 12 të "Marrëveshjes mbi kushtet për aksesin e lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor"; Rregulloren/Dokumentin e procedurave të miratuara nga "Komiteti i Përbashkët" (sipas nenit 13 të marrëveshjes); -listën e pjesëmarrësve në "Komitetin e Përbashkët" - emër mbiemër, pozicion pune dhe institucioni përkatës; -raportet e monitorimit të zbatimit të prodhuara nga "Komiteti i Përbashkët", që nga hyrja në fuqi e saj deri më sot (sipas nenit 13 të marrëveshjes); - përfundimet e të gjitha mbledhjeve të mbajtura nga Komiteti i Përbashkët nga themelimi deri më sot (minuta takimi, dokumente pune); -aktet, dokumentet e miratuara apo të adoptuara nga Komiteti i Përbashkët; -protokollet shtesë që janë lidhur në zbatim të marrëveshjes (nëse ka, sipas parashikimeve të nenit 16 të marrëveshjes); -listën e ndryshimeve në legjislacionin kombëtar dhe aktet nënligjore në lidhje me miratimin dhe zbatimin e protokolleve të dala nga marrëveshje (nëse ka); -listën e akteve dhe neneve që janë ndryshuar (në funksion të zbatimit të marrëveshjes); -nëse disponon institucioni hapësirën fizike dhe infrastrukturën teknike për të mundësuar zbatimin e kësaj marrëveshje; -nëse disponon institucioni stafin e nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshje; -çdo informacion tjetër apo angazhim të punonjësve të institucionit në kuadër të Nismës Ballkani i Hapur 	<p>Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zbatim të VKM-së Nr. 110, datë 2.3.2022 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë".</p>	E deleguar
80	25.07.2023	07.08.2023	<p>Informacion se pasur parasysht kushtet e mia familjare që jam vetë kryefamiljare me dy fëmije pasi bashkëshorti me ka vdekur, nëse mund të kërkoj që të më fillojë pagesë shtesë për master shkencor meqenëse kam edhe mbi 10 vite pune</p>	<p>Informacion se duhet të paraqitet një kopje e dokumentacionit (diplomë dhe librezë pune) për të verifikuar nëse ka përputhje pozicioni i punës me diplomën. Nderkohë që për kategorizimin e nivelit të diplomës, duhet drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, meqenëse cikli i studimeve në infirmieri ka qenë më pak se katër vite.</p>	E plotë
81	26.07.2023	25.08.2023	<p>Informacion për marrje masash dhe verifikim në subjekt privat të ofrimit të kujdesit shëndetësor</p>	<p>Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor për të kryer verifikimet përkatëse në subjekt.</p>	E deleguar
82	28.07.2023	30.08.2023	<p>Informacion në lidhje me procedurat, kriteret, licensimin dhe mënyrën e funksionimit të prodhimit, me qëllim pajisjen ose jo me licencim ose shitjen e objektit tonë tek një investitor i cili do pajset me licensim</p>	<p>Informacion për marrjen në shqyrtim të kërkesës më datë 15.08.2023, informojnë se është miratuar Ligji Nr. 61/2023 "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", të cilin e gjeni të botuar në Fletoren Zyrtare Nr.124, datë 21.08.2023.</p>	E plotë
83	31.07.2023	15.08.2023	<p>Informacion çfarë procedurë ndiqet për nxjerrjen e një vule të re institucioni: qendra shëndetësore Lumxheri u bashkua me qendrën shëndetësore Antigone, për këtë arsye kërkojmë të pajsemi me vule të re institucionale</p>	<p>Informacion se referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 390, datë 6.8.1993 " Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare", e ndryshuar, duhet të paraqesni kërkesë me shkrim tek Ministria e Brendshme.</p>	E plotë

84	02.08.2023	28.09.2023	Informacion/kërkesë për vendosje në dispozicion të trembëdhjetë relacioneve përfundimtare të vendimeve të këshillit të ministrave	<p>Informacion se në përputhje me nenet 24 dhe 25 të Ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", ministritë e linjës hartojnë relacionin shpjegues për projektaktin, i cili ndër të tjera përmban shpjegimin për marrjen ose jo në konsideratë, të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrave ose të institucioneve të tjera të interesuara.</p> <p>Sipas nenit 16 të ligjit nr. 9000/2003, gjatë mbledhjes së Këshillit të Ministrave, ministrat kanë të drejtë të shfaqin mendimin e tyre mbi projektaktet që janë dërguar paraprakisht për mendim, sipas nenit 24 të ligjit. Më tej, pika 62 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar, parashikon se: "Drejtuari i mbledhjes paraqet thelbin e projektaktit, i kërkon ministri propozues, nëse ka komente lidhur me propozimin e tij dhe në pas fiton anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave për të shprehur mendimin e tyre".</p> <p>Sipas nenit 17, të ligjit 9000/2003, çdo anëtar i Këshillit të Ministrave, është i detyruar të respektojë vendimet e marra në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe çdo vlerësim, debat apo raportim duhet të mbetet konfidencial.</p> <p>Në këtë kuptim, mendimi i dhënë nga çdo anëtar i Këshillit të Ministrave është pjesë e pandashme e procesit të shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve dhe është baza e diskutimeve, vlerësimeve dhe debateve në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj mbledhjeje ministrat e linjës shprehen duke u bazuar në mendimin që kanë dhënë paraprakisht mbi projektvendimin gjatë procesit të hartimit dhe bashkërendimit të projektakteve.</p> <p>Pra, mendimet që japin ministritë e linjës për projektaktin, si dhe shpjegimi që ministri i linjës jep në relacionin shpjegues të çdo projektakti, për marrjen ose jo në konsideratë, të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrave ose të institucioneve të tjera të interesuara, është pjesë e procesit vendimmarrës të Këshillit të Ministrave, i cili nuk mund të bëhet publik për shkak të kufizimeve të vendosura në nenin 17 të ligjit 9000/2003. Në përputhje me këtë dispozitë, mendimet e dhëna nga ministritë e linjës dhe shpjegimet e dhëna nga ministrat e linjës për marrjen ose jo në konsideratë, të tyre, janë pjesë e pandashme e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit të çdo mbledhjeje të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Rrethimisht, ky detyrim, i lexuar bashkërisht me kufizimet e përcaktuara nga neni 17 i ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në përjashton nga detyrimi për t'u vendosur në dispozicion informacionin që keni kërkuar.</p>	E plotë
85	04.08.2023	10.08.2023; 23.08.2023	Informacion lidhur me operacionet e goditjes cerebrale, a bëhen në spitalin shtetëror në QSUT; arsyeja që nuk është realizuar ndërhyrja e personit të referuar, në spitalin shtetëror dhe ka bërë operacionin në spital privat; nëse ka ardhur ky person në spitalin shtetëror për të kërkuar të operohet	<p>Përcjellë për trajtim dhe kompetencë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë: Informacion se në QSUNT trajtohen në numër shumë i madh pacientësh me të gjitha llojet e patologjive. Vetëm për vitin 2022, janë shërbyer e trajtuar në total (shtrime dhe shërbime ambulatorie) 525.616 qytetarë. Numri i pacientëve të trajtuar në Spitalin e Neuroshkencës për patologji neurovaskulare është 4816 pacientë për vitin 2022, të trajtuar nëpërmjet ndërhyrjeve kirurgjikale dhe trajtimeve invasive të llojeve të ndryshme.</p> <p>Qendra e parë e trajtimit të aksidenteve vaskulare cerebrale (trombolizës) u krijua në QSUNT në vitin 2016. Qendra e trombolizës vazhdon aktivitetin me shifra suksesi të nivelit bashkëkohor, ku deri më sot janë shërbyer mbi 700 pacientë.</p> <p>Trajtimi i aksidenteve cerebrovaskulare nëpërmjet trombolizës, kryhet me sukses të krahasueshëm me të njëjtin koeficient si në spitalet europiane, bazuar në protokollin mjekësor të kohës së përfuturit, falë mundësisë 100% të ekzaminimeve imazherike dhe laboratorike në kohë reale nga shërbimi i urgjencës dhe Njësia e Stroke.</p> <p>Diagnoza e sëmundjeve neurovaskulare kryhet sipas standartit bashkëkohor nga neuroradiologë dhe teknikë të cilët kanë në dispozicion pajisje të fjalës së fundit, si rezonanca 3 Tesla, e vetmja e këtij lloji në Shqipëri, si dhe aparatura angiokanera me prerje të larta (deri 128). (Sa më sipër informojmë se aparaturat në Shërbimin e Neurokirurgjisë janë në sistem mirëmbajtje dhe përdoren të gjitha sipas protokolleve mjekësore të përcaktuara nga shërbimet klinike).</p> <p>Përsa i përket procedurës DSA (vizualizimi me kontrast i rrjetit të enëve të gjakut të trurit), sot kryhet në Shqipëri nëpërmjet bashkëpunimit me Spitalin Memorial, pas konsultimit paraprak mes stafëve mjekësorë, pra shërbimi për këtë protokoll sigurohet për pacientët që referohen për këtë ekzaminim.</p> <p>Aparaturat e nevojshme për kryerjen e procedurave invazive të këtyre kategorive (enëve të gjakut të zemrës, kokës dhe periferike) janë angiografët. Në spitalin e Neuroshkencës ndodhet një prej katër angiografëve që disponon QSUT (të gjithë funksionale), në të cilën kryhen procedurat endovazale prej vitesh me përfitim shumë të madh për jetën e pacientit.</p> <p>Përgjatë këtyre viteve në mënyrë të vazhdueshme, mjekët specialistë neuroradiologë kanë kryer procedurat endovazale, me metod a invasive, si dhe po aftësohen në vijimësi për trombektominë dhe kryerjen e saj.</p> <p>Në kuadrin e investimeve të reja nga MSHMS, në Spitalin Qendror të QSUNT është instaluar një pajisje e re. Angiograf, e tipit COMBI në Urgjencë, që mundëson kryerjen e diagnozës dhe trajtimit të trombeve (me shkaqe të ndryshme) në enët e gjakut të zemrës, kokës dhe periferike. Para lelisht me kryerjen e procedurave të ekzaminimeve dhe trajtimeve invasive në zemër, apo vazat karotide, po punohet njëherazi për fillimin e kryerjes në këtë strukturë dhe të trombektomisë sipas protokolleve përkatëse.</p> <p>Në vijim të punës për shtimin e trajtimeve të reja në QSUNT, sikurse është procedura e trombektomisë, po ecet me një plan veprimi të qartë dhe një grup pune, që po ndjek hap pas realizimin në një kohë të afër të kësaj procedure.</p>	E deleguar; E plotë
86	04.08.2023	14.08.2023	Informacion sa laboratorë privatë biokimikë janë licensuar nga ministria e shëndetësisë dhe sa prej tyre ofrojnë aktivitet; sa shkelje janë konstatuar në sa subjekte dhe sa gjoba janë vendosur; sa subjekteve që ofrojnë shërbim laborator biokimik u janë hequr licensat; cilat kanë qenë shkeljet që janë konstatuar në këto subjekte	<p>Informacion se bazuar në Ligjin Nr.10081, datë 23.09.2009 "Për Licencat dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 "Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta" të ndryshuar,</p> <p>veprimtaria "Shërbime laboratorike" ndahet si më poshtë vijon :</p> <p>II.6.A.1 Shërbime laboratorike : Laborator mikrobiologjik II.6.A.1 Shërbime laboratorike : Laborator klinik biokimik II.6.A.1 Shërbime laboratorike : Laborator gjenetik</p> <p>Institucioni vendimmarrës për licensimin e laboratorëve klinik biokimik është vetëm Qendra Kombëtare e Biznesit, për informacionin e kërkuar mund t' i drejtoheni Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në bazë të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 7643, datë 02.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar" të ndryshuar, të Vendimit Nr.696, datë 16.08.2013, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portarit unik "e-Inspektimi", si dhe të Vendimit Nr.241, datë 27.03.2013 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor" dhe të "Rregullores së brendshme të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor" përcaktohet se: "Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik, si dhe është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë me përjashtim të inspektimeve në fushën farmaceutike". Për sa në sipër, për laboratorët që konstatohen shkelje gjatë ushtrimit të aktivitetit duhet t' i drejtoheni Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.</p>	E plotë
87	08.08.2023	23.08.2023	Informacion për vërtetimin që dokumenton ngjarjen e ndodhur të referuar	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.	E deleguar

88	09.08.2023	24.08.2023	Informacion për tregtimin e barnave dhe vaksinave të cilat do të importohen në vend të caktuar referent dhe cila është procedura që duhet të ndiqet për të bërë të mundur importin e tyre dhe në pas shtjën	Informacion se referuar Ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", i ndryshuar, neni 11, pika 1, "Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregtim nga Agjencia." Referuar ligjit 105/2014 neni 12 pika 1, "aplikimi dhe praktika e dhënies së autorizimit të tregimit kryhen pranë Agjensisë nga prodhuesit vendas të licensuar, mbajtësi i autorizimit për tregtim, edhe kur ky nuk është prodhues i barni, sipas rregullave të percaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave" Referuar ligjit 105/2014 neni 32 pika 1, "Barnat e autorizuar në Republikën e Shqipërisë importohen nga importuesit e autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregimit, pas pajisjes me autorizim importi të lëshuar nga Agjencia, në bazë të regjistrat të botuar të barnave." Referuar ligjit 105/2014 neni 33 pika 1, "Importi i barnave të paautorizuara bëhet me autorizim të veçantë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë për çdo seri." Kriteret e dhënies së autorizimit dhe elementet e tij përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 142, date 18.02.2015 "Për përcaktimin e rregullave për lëshimin e autorizimit të ministrit të shëndetësisë për importimin e barnave pa autorizim për tregtim." Ky ligj zbatohet për barnat dhe vaksinat për përdorim njerëzor, të destinuara për t'u vendosur në tregun e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të vaksinave të personalizuara. Për çdo informacion të mëtejshëm mund t'i referoheni legjislacionit në fuqi dhe Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore si institucion përgjegjës.	E plotë
89	09.08.2023	23.08.2023	Informacion për raport mjekësor	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim strukturës përkatëse shëndetësorë spitalore.	E deleguar
90	14.08.2023	23.08.2023	Informacion për funksionimin EKG në Apple Watch që nuk disponohet në Shqipëri, nëse ka ndonjë plan për ta bërë të disponueshëm edhe në vendin tonë	Informacion se në zbatim të VKM Nr.609, datë 20.10.2021 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" kërkesa nuk është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.	E plotë
91	15.08.2023	23.08.2023; 24.08.2023	Informacion për kërkesë dhe rikërkesë për rivlerësim të çertifikatës mjekësore për shtetas të referuar në kërkesë	Përcjellë për trajtim dhe kompetencë Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë; Informacion nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë se të gjitha procedurat mjekësore janë ndjekur sipas protokolleve. Qytetari ka marrë vlerësim tek mjeku specialist dhe është paraqitur pranë një Komisioni Mjeko-Ligjor i cili ka marrë vendim unanim. Duke qenë se Certifikata Mjekësore është e rregullt në çdo procedurë të saj i neget Drejtorisë së Drejtuesve të Mjeteve të Interpretuara dhe zbatohet ligjet në fuqi në bazë të Certifikatës Mjekësore të lëshuar nga mjekët.	E deleguar; E plotë
92	15.08.2023	25.08.2023	Informacion për procedurën mbi marrjen e një vule apostile nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për një certifikatë mjekësore (që vërteton se gëzoj shëndet të plotë), në mënyrë që të pajisem me vule nga Ministria e Jashtme në pas për dorëzim në ambasadë	Informacion për t'u paraqitur pranë recepsionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku duhet të dorëzohet dokumenti mjekësor, i cili do të verifikohet nëse është i rregullt ose jo dhe më pas do të vazhdohet me procedurën e legalizimit për vendosjen e vulës apostile nga ana jonë.	E plotë
93	19.08.2023	23.08.2023	Informacion për ndërrim mjeku të familjes	Informacion për mundësi ndryshimi të mjekut të familjes duke aplikuar në portalin e-Albania, në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14471 .	E plotë
94	04.09.2023	29.09.2023	Informacion nëse është funksionale pajisja e Brakiterapisë në shërbimin e Onkologjisë në QSUT; sa pacientë nuk kanë marrë shërbim për shkak të mungesës së kësaj pajisje; ku janë adresuar për ta marrë këtë shërbim këta pacientë; prej sa kohësh nuk funksionon kjo pajisje; kur priret të vihet në punë pajisja e Brakiterapisë në shërbimin e Onkologjisë në QSUT; nëse është funksionale pajisja e Ortovoltazhit në shërbimin e Onkologjisë në QSUT; sa pacientë nuk kanë marrë shërbim për shkak të mungesës së kësaj pajisje; ku janë adresuar për ta marrë këtë shërbim pacientët; prej sa kohësh nuk funksionon kjo pajisje; kur priret të vihet në punë pajisja e Ortovoltazhit në shërbimin e Onkologjisë në QSUT	Informacion nga QSUT se pajisja e Brakiterapisë priret të zhvendoset në një ambient të pajisur me të gjithë elementët e sigurisë për mbrojtjen nga rrezatimi, në të cilin më parë ka qenë e instaluar pajisja e Kobalto – Terpisë, pajisje e zhvendosur së fundmi nga ekspertët e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore (IAEA). Bazuar në informacionin e përcjellë nga Shërbimi Onkologjik, numri i pacientëve që janë trajtuar me opsione mbështetëse të kësaj terapie është mesatarisht 60-65 pacientë/vit. Shërbimi Onkologjik trajton raste me diagnozën përkatëse të kancerit dhe në dijeni tonë nuk ka qendër referente për këtë trajtim. Kjo aparatë ka disa kohë që nuk është në përdorim, por në mungesë të saj, rekomanduar nga protokollet përkatëse, trajtimi është kryer nëpërmjet përshtatjes së dozave të rrezatimit të jashtëm, me qëllim realizimin dhe parandalimin e këhimit apo trajtime të tjera ndihmëse siç është kimioterapia. Kjo pajisje, ashtu si shpërguar në pikën 1, është parashikuar që të zhvendoset brenda vitit 2023, nga ekspertët e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore (IAEA). Pajisja e Ortovoltazhit ka pësuar një defekt të rëndë i cili ka qenë i pamundur të riparohet për shkak të mungesës së pjesëve të këmbimit. Aktualisht pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, kemi një pajisje të re Ortovoltazhit të dhuruar së fundmi nga IAEA, e cila është parashikuar që të instalohet në ambientet ku aktualisht ndodhet pajisja e vjetër e Ortovoltazhit. Duke qenë se pajisja e re që do të instalohet në këtë ambient ka parametra dhe rrezatim të ndryshëm nga ajo aktuale dhe nga IAEA është rekomanduar që të kryhet ripërforcimi antirezatim (shielding) i këtij ambienti. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, po ndjek procedurat për të implementuar në këtë ambient të gjithë elementët e nevojshëm për mbrojtjen e përshtatshme nga rrezatimi që emeton pajisja e re, procedurë kjo që është në proces. Numri i pacientëve që duhet të trajtohen me pajisjen Ortovoltazhit është mesatarisht 200-250 pacientë/vit. Nuk ka një praktikë për të adresuar pacientët që kanë nevojë për këtë lloj trajtimi, por QSUNT ka asistuar këto pacientë duke përshatur trajtimet, ashtu si shpërguar në pikën 4. Aparatura e Ortovoltazhit nuk është funksionale prej fundit të vitit 2022. Në mungesë të këtij trajtimi, pacientët kanë marrë trajtimeve alternative bazuar në protokollet e miratuar për diagnozën përkatëse. Kjo pajisje është parashikuar që të vendoset në punë nga ekspertët e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore (IAEA) brenda vitit 2023.	E plotë

95	04.09.2023	29.09.2023	Informacion për vendosje në dispozicion të relacioneve përfundimtare të katër vendimeve të Këshillit të ministrave	<p>Informacion se në përputhje me nenet 24 dhe 25 të ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", ministritë e linjës hartojnë relacionin shpjegues për projektaktin, i cili ndër të tjera përmban shpjegimin për marrjen ose jo në konsideratë, të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrave ose të institucioneve të tjera të interesuara.</p> <p>Sipas nenit 16 të ligjit nr. 9000/2003, gjatë mbledhjes së Këshillit të Ministrave, ministrat kanë të drejtë të shfaqin mendimin e tyre mbi projektaktet që janë dërguar paraprakisht për mendim, sipas nenit 24 të ligjit. Më tej, pika 62 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar, parashikon se: "Drejtuari i mbledhjes paraqet thelbin e projektaktit, i kërkon ministri propozues, nëse ka komente lidhur me propozimin e tij dhe më pas fton anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave për të shprehur mendimin e tyre".</p> <p>Sipas nenit 17, të ligjit 9000/2003, çdo anëtar i Këshillit të Ministrave, është i detyruar të respektojë vendimet e marra në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe çdo vlerësim, debat apo raportim duhet të mbetet konfidenciale.</p> <p>Në këtë kuptim, mendimi i dhënë nga çdo anëtar i Këshillit të Ministrave është pjesë e pandashme e procesit të shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve dhe është baza e diskutimeve, vlerësimeve dhe debateve në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj mbledhje ministrat e linjës shprehen duke u bazuar në mendimin që kanë dhënë paraprakisht mbi projektvendimin gjatë procesit të hartimit dhe bashkërendimit të projektakteve.</p> <p>Pra, mendimet që japin ministritë e linjës për projektaktin, si dhe shpjegimi që ministri i linjës jep në relacionin shpjegues të çdo projektakti, për marrjen ose jo në konsideratë, të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrave ose të institucioneve të tjera të interesuara, është pjesë e procesit vendimarrës të Këshillit të Ministrave, i cili nuk mund të bëhet publik për shkak të kufizimeve të vendosura në nenin 17 të ligjit 9000/2003. Në përputhje me këtë dispozitë, mendimet e dhëna nga ministritë e linjës dhe shpjegimet e dhëna nga ministrat e linjës për marrjen ose jo në konsideratë, të tyre, janë pjesë e pandashme e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit të çdo mbledhjeje të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Rrejdhimisht, ky detyrim, i lexuar bashkërisht me kufizimet e përcaktuara nga neni 17 i ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", na përjashton nga detyrimi për t'ju vendosur në dispozicion informacionin që keni kërkuar.</p>	E plotë
96	05.09.2023	25.09.2023	Informacion për akreditim biznesi dhe përfshirjen në database e institucionit adresën elektronike që mund ta përdorni për të njoftuar/komunikuar çdo mundësi konsultimi/përfshirje/bashkëpunimi midis institucionit tuaj dhe shoqatës sonë, mbetemi në pritje të konfirmimit të pranimit të kërkesës sonë	Informacion për saktësim objekti të kërkesës duke specifikuar konkretisht kërkesën drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bazuar dhe referuar fushës së përgjegjësisë së miratuar me VKM Nr.609, datë 20.10.2021 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".	E plotë
97	12.09.2023	21.09.2023	Informacion për vendosje në dispozicion kontratë konkencionare	Informacion se në bazë të nenit 14, pika 1 dhe 2 e Ligjit Nr.125/2013 "Për Konkencionet dhe Partneritetin Publik Privat", të ndryshuar, kontratat e konkencionit dhe partneritetit publik privat përbëjnë një bazë të dhënash elektronike të regjistrit të konkencionit/partneritetit të publik privat, që krijohet dhe mbahet nga Agjencia e Trajtimit të Konkencioneve (ATRAKO) dhe si të tilla ato gjenden të publikuara në këtë regjistrë. Për më tepër referohuni web linkut http://atrako.gov.al/?page_id=112 për të aksesuar kontratën konkencionare.	E plotë
98	13.09.2023	28.09.2023; 03.10.2023	Informacion për mbërrirjen në email vlerësimi i dosjes me pikë, kam aplikuar për portal, dega infermieri, qarku Tiranë	Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor; Informacion prej Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, pas verifikimit të rastit se aplikanti është njoftuar për vlerësimin e dosjes fillimisht me datë 11.09.2023, si dhe është rinjoftuar me datë 13.08.2023 pas kërkesës së tij që nuk kishte marrë email për vlerësimin. Bazuar në Udhëzimin Nr. 481 datë 27.06.2019 "Për procedurat e punësimit për profesionistët e shënjësve mjekësorë teknikë në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike" i ndryshuar, aplikanti është vlerësuar me pikët përkatëse.	E plotë
99	14.09.2023	04.10.2023	Informacion rreth vaksinave të detyrueshme, vërtetim vaksinimi për regjistrim në shkollë	<p>Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik, nëpërmjet Programit të Vaksinimit, synon të mbrojë popullatën dhe çdo individ nga sëmundjet që parandalohen nga vaksinat nëpërmjet sigurimit të vaksinave të duhura sipas grup moshave dhe sëmundjeve përkatëse, të kontrolluara për cilësinë dhe efikasitetin e tyre si dhe nëpërmjet ofrimit të mbishqetësive teknike dhe udhëzimeve për zbatimin e programit të vaksinimit dhe udhëheqjen e monitorimit të tij për çdo njësi që ofron kujdes shëndetësor. Kalendarit i detyruar i vaksinimit përfshin një sërë vaksinash që aplikohen që në lindje, deri në moshën 18-vjeç, duke nisur nga vaksinat për tuberkulozin, hepatitin viral B, difterinë, tetanosin, pertusis, infeksionet nga haemophilus influenzae tipi B, poliomielitit, infeksionet nga rotavirus, infeksionet nga pneumokoku, fruth-rubeole-parotiti dhe HPV. Aplikimi i këtyre vaksinave bëhet në moshë dhe doza të ndryshme, sipas kalendarit në vijim. Në Shqipëri, programi i imunizimit është një histori suksesi dhe një nga shtyllat e mbrojtjes së shëndetit. Gjatë viteve të fundit, programi ka futur vakcina të reja si dhe është përmirësuar zinxhiri i ftohtës dhe infrastruktura. Në 1 Tetor të vitit 2019, u fut në programin kombëtar të vaksinimit, vakcina ndaj infeksioneve të rotavirus. Kjo vaksinë është falas për të gjithë fëmijët e lindur që nga data 1 Gusht 2019. Vakcina ndaj infeksioneve nga rotavirus është mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga rotavirusi, i cili është shkaktari më i shpeshtë i gastroenteritit tek fëmijët e vegjël. Ai përthapet lehtë dhe mund të shkaktojë diarje të rënda (ujore) si dhe shenja të tjera serioze që mund të çojnë në dehidratim dhe shpesh bëjnë që fëmija të shtrohet në spital. Duke nisur nga data 01.11.2022 kalendarit kombëtar të vaksinimit i'u shtua edhe një tjetër vaksinë, e cila do të aplikohet tek vajzat e moshës 13 vjeçare, për të parandaluar rrezikun e shfaqjes së kancerit të qafës së mtrës. Konkretisht, bëhet fjalë për vaksinën kundër humanpapillomavirusit (HPV). Vaksinimi i vajzave me këtë vaksinë do të ndihmojë në parandalimin e prekes së tyre nga kanceri i qafës së mtrës, një sëmundje kjo që në ditët e sotme është mjaft shqetësuese. Jo vetëm sa i takon përthapjes, por edhe pasojave fatale që mbart për shkak të diagnostikimit të saj në stadi të rënduar, kur sëmundja ka avancuar së tepërmi. Kjo vaksinë është 4-valente dhe aplikohet tek vajzat e lindura nga data 1 Janar 2009 e në vazhdim. Në moshën 6 vjeç fëmijët kryejnë vaksinën DT(difteri-tetanoz), OPV (poliomieli), Vakcina e DT është e firmës BB-NCIPD prodhuar në Sofia, BULLGARI me numër loti: C2152 dhe me skadencë 12.2024. Vakcina OPV është e firmës BIOFARMA, Bandung, INDONEZIA me numër loti: 2055322 dhe me skadencë 06.2024. Kalendarit kombëtar i vaksinimit është i aksesueshëm në faqen zyrtare të Institutit të Shëndetit Publik në linkun: https://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Tetor-2022-Kalendar-i-ri-i-vaksinimit_page-0001-2.jpg</p>	E plotë

100	19.09.2023	26.09.2023	<p>Informacion për rastin e Spitalit Psikiatrik Vlorë "Ali Mihal" si dhe linku i emisionit: https://youtu.be/LD60JHrjzyM?si=0vRppO68asTsD21.</p> <p>Një qendrim zyrtar nga MSH për këtë rast, grupet e inspektimit, masat, çfarë do lloj informacioni rreth çështjes</p>	<p>Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ngritur me Urdhër të titullarit grupin e inspektimit me përfaqësues nga ministria dhe drejtoria rajonale e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Vlorë. Grupi i inspektimit ka për detyrë verifikimin dhe vlerësimin e kushteve të ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor për pacientët kronikë me çrregullime të shëndetit mendor të shtruar në Spitalin Psikiatrik Vlorë "Ali Mihal". Gjithashtu në përfundim të inspektimit grupi do të rekomandojë ndërhyrje që duhet të ndërmerrin nga administrata e Spitalit Psikiatrik "Ali Mihal" si dhe nga stafi mjekësor për ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor dhe me dinjitet për pacientët kronikë të hospitalizuar në këtë spital. Gjithashtu ju bëjmë me dije se brenda 2 javëve do të fillojë në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihal", Vlorë zbatimin e projektit i infrastrukturës me vlerë investimi 149.469.178 lekë që përfshin rehabilitimin e 2 godinave të pavionit kronik (godina ku janë të akomoduar pacientët burra do të prishet dhe do të ndërtohet e re (përfundon 10 muaj nga fillimi i punimeve) ndërsa godina ku janë të akomoduar pacientët gra do të rehabilitohet (përfundon 6 muaj nga fillimi i punimeve). Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka prioritetuar shëndetin mendor në axhendën e saj 2030, si dhe ka alokuar fonde investimi për rikonstruksionin e të tre spitalëve psikiatrike të Vlorës, Elbasanit dhe Spitalit Psikiatrik në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" deri në vitin 2025. Gjithashtu është miratuar plani i veprimit për shëndetin mendor 2023-2026 që mbështet parimin "nuk ka shëndet pa shëndet mendor", duke identifikuar objektiva strategjike dhe masa ndërhyrjeje bazuar në sfidat pas pandemisë dhe zhvillimet e sektorit drejt mbulimit shëndetësor universal dhe synon të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe personave me aftësi të kufizuara mendore. Ky plan veprimi synon të sjellë një qasje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe adoleshentët, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara mendore, migrantët, viktimat e dhunës dhe trafikimit, etj, si grupe të çmueshme dhe në nevojë për kujdes të veçantë për shëndetin mendor.</p>	E plotë
101	20.09.2023	22.09.2023	<p>Informacion/Kërkesë e përcjellë për trajtim dhe kompetencë nga Qendra e Botimeve Zyrtare,për vendosje në dispozicion dy udhëzime: Udhëzim Nr.510/2011 dhe Udhëzim Nr.139/2011</p>	<p>Informacion se referuar verifikimeve tona subjekti ka marrë përgjigje prej Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor në rrugë elektronike më datë 22 shtator 2023, sikundër në komunikimin elektronik, të cilin e rigjieni bashkëlidhur së bashku me dokumentacionin përkatës.</p>	E plotë
102	22.09.2023	03.10.2023	<p>Informacion ku mund të gjenden kriteret e nevojshme dhe procedura për hapjen e një klinikeprivate okulistike</p>	<p>Informacion se në portalin e Qendrës Kombëtare të Biznesit me link https://qkb.gov.al/ gjendet informacion në lidhje me licencat në fushën e shëndetësisë sipas kategorive përkatëse. Bazuar në VKM Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar, përcaktohet: "Licencimi i veprimtarive të nënkategorisë II.6.A:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kabinete mjekësore vetëm me një specialitet mjekësor të tilla si: kabinete imazherie, kabinete optik me opticien , kabinete diagnostik endoskopike dhe specialitete të tjera me kodin A.2. 2. Qendër Mjekësore me disa specialitete mjekësore për vizita dhe konsulta mjekësore, diagnostikim, trajtime ambulatorie, trajtime mikrokirurgjiale me Kodin A.4.". Në rastin konkret, nëse kemi vetëm një mjek që do të ushtrojë aktivitetin si mjek okulist duhet të zgjidhet kabinete mjekësor, në të cilin drejtuesi teknik (mjekësor) është mjeku okulist. Nëse kemi të bëjmë me disa specialitete duhet të zgjidhen kriteret për Qendër Mjekësore. Informacion/bashkëngjitur kriteret për Kabinete Mjekësore dhe Qendër Mjekësore, të marra nga Regjistrimi Informativ i Lejeve dhe Licencave, veprimtari të cilat i përkasin grupit të II të licencave ku autoritet vendimarrës është vetëm Qendra Kombëtare e Biznesit. 	E plotë
103	24.09.2023	29.09.2023	<p>Informacion për sa i përket konkurimit për punësimin e psikologut në qendra shëndetësore, nëse më lejohet të marr pjesë në konkurim dhe të punësohem në qendër shëndetësore edhe pse jam në proces licencimi apo kjo gjë më penalizon</p>	<p>Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor.</p>	E deleguar
104	02.10.2023	16.10.2023	<p>Informacion për sa i përket Fekondimit In Vitro (IVF) në maternitetet shtetërore</p>	<p>Informacion se Procesi i realizimit të fertilizimit in vitro në strukturat publike është një proces që po ndjek të gjitha etapat sipas planifikimit. Pranë Spitalit Obstetrik Gjinjekologjik "Kçoço Gllözheni" ka përfunduar investimi në infrastrukturën ndërtimore dhe janë në proces procedurat për blerjen e barnave dhe materialeve mjekësore të nevojshme, në zbatim të protokolleve mjekësore. Protokollet e përzgjedhjes, të aplikimit dhe të ndjekjes së procedurës kanë përfunduar. Janë trajnuar gjithashtu burimet njerëzore të afta për të asistuar këtë procedurë. Kjo qendër është parashikuar të vihet në funksionim brenda këtij viti</p>	E plotë
105	10.10.2023	26.10.2023	<p>Informacion për sa i përket akteve ligjore në fuqi për COVID 19 të detyrueshme për zbatim për bizneset në kuadër të sigurisë dhe shëndetit në punë</p>	<p>Informacion se gjendja e epidemisë së shkakuar nga infeksioni Covid-19 u shpall me Urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 156/2 datë 11.03.2020 "Për shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni Covid-19". Ky udhër është në fuqi dhe gjendet i botuar në Fletoren Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Aktet ligjore/nënligjore të dala me qëllim luftimit dhe parandalimit e infeksionit të shkakuar nga Covid -19, që ishin të detyrueshme për zbatim nga bizneset, nuk janë në fuqi.</p>	E plotë
106	16.10.2023	17.10.2023	<p>Informacion për të drejtë e e ushtrimit të profesionit të mjekut në Republikën e Shqipërisë</p>	<p>Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.</p>	E deleguar
107	16.10.2023	18.10.2023	<p>Informacion në lidhje me infermierët në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë</p>	<p>Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.</p>	E deleguar
108	18.10.2023	30.10.2023	<p>Informacion për sa i përket numrit të lindjeve për vitin 2022 dhe 6 muajorin e parë të 2023</p>	<p>Informacion se numri i lindjeve për vitin 2022 dhe 2023 gjendet i publikuar në faqen zyrtare të INSTAT në linkun: https://www.instat.gov.al/temat/rgjesit-d-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesa/</p>	E plotë
109	31.10.2023	01.11.2023	<p>Informacion në lidhje me raport mjeko ligjor me 4 vula për marrjen e nënshetësis Bullgare</p>	<p>Përcjellë për kompetencë dhe trajtim Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor</p>	E deleguar

110	06.11.2023	01.12.2023	Informacion rreth hemofilisë B.	<p>Informacion se Hemofilia është një patologji e lindur me transmetim gjenetik që shkakton deficit të faktorit tetë të koagulimit të gjakt dhe që shoqërohet me fenomene hemorragjike në vende të ndryshme të trupit. Pacientët kanë nevojë për marrjen periodike të faktorit tetë të zvendësues apo medikamenteve të tjera në varësi të situatave. Këta pacientë trajohen me faktorin tetë zvendësues me ose pa faktorin shoqërues Von Willebrand.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe ka lidhur marrëveshjen kuadër për: "B2- Blerje barna gjaku dhe organet formuese të gjakut.; ndarë në 124 lot - lot 73 Human Coagulation factor VIII ose Human Coagulation Factor VIII + Human Von Willenbrand Factor 250IU-1000IU UI," në varësi të kësaj marrëveshje kuadër janë lidhur kontratat për këtë medikament. Marrëveshje kuadër është lidhur dhe për faktorin VIII rekombinant. Gjithashtu është marrë donacion nga një marrëveshje e bërë mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Ministrinë Italiane të Shëndetësisë, një sasi Faktor VIII 1000 UI.</p> <p>Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë ka si qëllim trajtimin e pacientëve dhe ofron trajtimin bazë, në lidhje me metodat e tjera, janë bërë diskutime përkatëse për të bërë çdo përpjekje për ti pasur si alternativa.</p> <p>Që prej fillimit të zbatimit të Kontratës koncesionare, për ofrimin e shërbimit laboratorik, në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë ofrohen 164 teste laboratorike për pacientët ambulator dhe të hospitalizuar, të cilët janë parashikuar në këtë kontratë.</p>	E plotë
111	08.11.2023	01.12.2023	Informacion rreth raportit progresit të vitit 2022 në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale. Çfarë paketash sociale dhe ekonomike janë ofruar për familjet në nevojë? Sa është fondi i buxhetit të shtetit për vitin 2023 që shkon për fondet speciale për secilin kategori specifikisht? (Pensionet, ndihmat sociale etj)	<p>Informacion se Raportin e Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë në linkun: https://shendetesia.gov.al/perkujdesi-social</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bazohet në matjen e nivelit të standartit të jetesës, nëpërmjet Anketës së Matjes së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (SILC), e cila realizohet nga Instituti i Statistikave.</p> <p>Treguesit e varfërisë në anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, bazohen në konceptin relativ të varfërisë, i cili merr në konsideratë të ardhurat familjare të disponueshme, madhësinë e familjes dhe shpërndarjen e të ardhurave ndërmjet grupeve të popullsisë. Te dhënat mbi nivelin e varfërisë në vend sipas SILC, janë të publikuar në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në fushën e përgjegjësisë së saj ka hartimin e politikave, të programeve dhe legjislacionit për programet e asistencës sociale. Programi i ndihmës ekonomike mbështet të gjithë familjet dhe individët në nevojë. Numri i përfutësve nga programi i ndihmës ekonomike është rreth 64,000 familje.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ndërmarrë një sërë masash për të mbështetur kategoritë në nevojë dhe rritjen e masës së ndihmës ekonomike si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Rritje e pagesës me 20% për rreth 64,000 familjet përfutëse; ✓ Dyfishim e masës së përfutimit për familjet me 3 apo më shumë fëmijë (për rreth 11 mijë familje përfutëse); ✓ Dyfishim e masës së përfutimit për gratë kryefamiljare me deri në dy fëmijë (për rreth 6 mijë gra kryefamiljare); ✓ Dyfishim e masës së përfutimit për individët mbi 65 vjeç të vetmuar, që nuk përfitojnë pension pleqërie/social (për rreth 5 mijë individë përfutëse); ✓ Trefishim e masës së përfutimit për rreth 800 jetimë dhe rreth 1,000 viktimë dhune e trafikimi. ✓ Subvencione shtesë për familjet me fëmijë të vegjël për vaksinimin dhe arsimimin e tyre.. ✓ Kompensime të energjisë elektrike dhe lehtësira të tjera si libra shkollore falas, çerthe e kopshte falas, banesa sociale, bursa për fëmijët që arsimohen etj, duke siguruar që në çdo politikë të re të kemi mundësinë që të prioritetizohet familjet e skemës së Ndihmës Ekonomike. <p>Për të mbështetur nënat e papuna që kanë më shumë se tre fëmijë, që nga janari i këtij viti ka filluar zbatimin programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç. Në zbatim të Vendimit nr. 751, datë 1.12.2022 " Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç", grave të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujtesës ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare, njihet si periudhë sigurimi për efekt përfutimi pensioni pleqërie dhe barrëlidhjeje.</p> <p>Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paguhen në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi. Aktualisht përfitojnë nga ky program rreth 8,200 gra të papuna me tre apo më shumë fëmijë.</p> <p>Fondi i ndihmës ekonomike për vitin 2023 është në vlerën 7,2 miliardë lekë.</p>	E Plotë
112	10.11.2023	24.11.2023	<p>Informacion se si janë të ndara në qarqe dhe grupmoshat respektive në qarqe të personave me SD perfitues të ndihmës ekonomike ?</p> <p>Sa është fondi mujor i pagesave për personat me SD sipas qarqeve?</p> <p>Sa është fondi mujor i dedikuar pagesave se aftësisë së kufizuar për personat me SD dhe sa është fondi mujor për kujdestarinë?</p> <p>Sa persona me SD janë perfitues të shërbimeve publike, dhe si janë të shpërndara, bazuar edhe në grupmosha, sipas qarqeve? Çfarë lloji të shërbimeve publike përfitojnë?</p>	<p>Informacion se në total, 690 persona janë përfutës të pagesës së aftësisë së kufizuar me Sindromën Down. Sipas qarqeve ato ndahen në: Qarku Berat 43, Qarku Dibër 33, Qarku Durrës 84, Qarku Elbasan 32, Qarku Fier 37, Qarku Gjirokastrë 33, Qarku Korçë 18, Qarku Kukës 24, Qarku Lezhë 69, Qarku Shkodër 52, Qarku Tiranë 213, Qarku Vlorë 52.</p> <p>Fondi për përfutësit e skemës së aftësisë së kufizuar është në të njëjtin zë buxhetor për të gjitha kategoritë përfutëse të aftësisë së kufizuar.</p> <p>Aktualisht, marrin shërbim persona me Sindromën Down 5 përfutës në 6 qendra publike zhvillimi rezidenciale për PAK (Shkodër, Berat, Korçë, Durrës, Golem, Vlorë) dhe 6 përfutës në 2 qendra publike ditore për PAK (Lezhë dhe Korçë).</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të Fondit Social, i cili është një mekanizëm financiar që mbështet bashkë dhe qarqet për ngritjen e shërbimeve komunitare sociale, deri më sot, për periudhën 2020-2023, janë ngritur 15 shërbime për aftësinë e kufizuar, ku mund të marrin shërbim dhe persona me Sindromën Down. Për momentin nuk e kemi numrin aktual të personave me Sindromën Down që trajtohen aktualisht në këto qendra.</p> <p>Më poshtë lista e shërbimeve (tipologjia dhe bashkia apo qarku ku ofrohet shërbimi) :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shërbim ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar - Bashkia Gramsh – Qarku Elbasan. 2. Shërbim ndërhyrës i përkujdesit shoqëror për fëmijët me aftësi të kufizuar -ÇSA - Bashkia Elbasan - Qarku Elbasan. 3. Shërbim ditore për fëmijët me aftësi të kufizuar - Bashkia Gjirokastrë – Qarku Gjirokastrë. 4. Shërbim rezidencial për persona me aftësi të kufizuar 30-60 vjeç Shkodër – Qarku Shkodër. 5. Shërbimi Lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar - Bashkia Lezhë. 6. Shërbim i integruar lëvizës komunitar për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuar – Bashkia Librazhd. 7. Shërbim ditore për persona me aftësi të kufizuar – Bashkia Lushnjë. 8. Shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar -Bashkia Rrogozhinë. 9. Shërbim në familje për personat me çrregullime të shëndetit mendor - Bashkia Patos. 10. Shërbim lëvizës për persona me aftësi të kufizuar – Bashkia Selenicë. 11. Shërbimi i specializuar për fëmijë e të rinj me aftësi të kufizuar në familje - Bashkia Gramsh. 12. Shërbimi i specializuar për fëmijë e të rinj me aftësi të kufizuar në familje dhe në Qendrën ditore - Bashkia Bukqizë. 13. Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për persona me aftësi të kufizuar - Shërbime lëvizëse pranë Qendres Komunitare - Bashkia Maliq. 14. Shërbime mbështetëse fizioterapie - psikosociale për persona me aftësi të kufizuar (para-tetraplegjik) - shërbime rehabilituese ditore - Bashkia Pogradec. 15. Qendra Multifunkcionale Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar - Bashkia Kamëz. 	E plotë

113	22.11.2023	06.12.2023	<p>Informacion rreth dokumenteve qe nevojiten per te marre nje license nga Ministria e Shendetesise per hapjen e nje ambulatori infermieristik.</p>	<p>Informacion se Në shtojcën e Ligjit Nr. 10081, datë 23.03.2009 "Për licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, janë përcaktuar të gjithë llojet e aktiviteteve që licencohen në Republikën e Shqipërisë, si edhe në fushën e shëndetësisë.</p> <p>Licencat në fushën e shëndetësisë që licencohen nëpërmjet QKB-së, janë veprimtarië si më poshtë vijon :</p> <p>II.6.A.1 Sherbime laboratorike : Laborator mikrobiologjik II.6.A.1 Sherbime laboratorike : Laborator klinik biokimik II.6.A.1 Sherbime laboratorike : Laborator gjenetik II.6.A.1 Sherbime laboratorike : Laborator dentar II.6.A.1 Sherbime laboratorike : Laborator Optik II.6.A.2 Kabinete mjekesore II.6.A.3 Klinike stomatologjike II.6.A.3 Kabinete stomatologjike II.6.A.4 Qender Mjekesore II.6.A.5 Sherbime te tjera shendetesore kurative II.7.A.1.F Farmaci II.7.A.1.Af. Agjenci Farmaceutike II.8.A Sherbime ekspertize higjeno-sanitare II.8.B Sherbime nderhyrese higjeno-sanitare</p> <p>Aktiviteti i kërkuar ambulator infermieristik nuk është i parashikuar për t'u licencuar më vete, por ushtrimi i profesionit të infermierit bëhet vetëm në kabinete/klinika apo spitale private.</p>	E plotë
114	30.11.2023	15.12.2023	<p>Informacion rreth marrjes së shërbimit check-up.</p>	<p>Informacion se çdo shtetas me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, që i përket grupmoshës 35-70 vjeç ka të drejtën e kontrollit mjekësor bazë, pa diskriminim. Kontrolli mjekësor bazë 35-70 vjeç është pa pagesë për shtetasit përfutës të programit. Ky program ofrohet dhe realizohet nga punonjësit e shëndetësisë në Kujdesin Shëndetësor Parësor, të kontraktuar nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.</p> <p>Vlen të theksohet që ky program është depistues në popullatë, pra i ofrohet popullatës së shëndoshë me qëllim identifikimin e parakohshëm të sëmundjeve jo të transmetueshme.</p>	E plotë
115	01.12.2023	14.12.2023	<p>Informacion rreth situatës së infertilitetit në Shqipëri</p>	<p>Informacion se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka në vëmendjen e saj, implementimin e një politike për pacientët me probleme të fertilitetit.</p> <p>Që prej vitit 2019 është planifikuar ngritja e një qendre për teknikën e Riprodhimit të Asistuar me buxhetet përkatëse, por ngjarja e tërmetit 2019 dhe më pas shpërthimi i SARS Covis-19, vuri në plan të dytë këtë proces.</p> <p>Që në fillimet e vitit 2023, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Glozhëni" nisën investimet përkatëse në infrastrukturë, për përshtatjen e ambienteve fizike, blerjen e pajisjeve mjekësore të nevojshme, materialeve mjekësore dhe barnave në përputhje me protokollet mjekësore.</p> <p>Aktualisht, jemi në fazën e kolaudimit të këtyre ambienteve dhe pajisjeve. U hartua protokoll mjekësor për Teknikën Mjekësore të Riprodhimit të Asistuar dhe brenda këtij muaji startojnë procedurat e para.</p> <p>Përsa i përket burimeve njerëzore, janë vendosur persona me një përvojë disavjeçare dhe të trajnuar në fushën e Fertilizimit Artificial.</p>	E plotë

116	01.12.2023	14.12.2023	<p>Informacion se cfare hapash apo dokumentacioni duhet te paraqitet qe nje shoqeri tregtare te pajiset me leje, license apo autorizim per importin e HCL.</p>	<p>Informacion se Referuar Ligjit Nr. 8874, datë 29.3.2002 "Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope", shtojca 1, lënda për të cilën ju bëni kërkesë, klasifikohet në kategorinë 3 të lëndëve që përdoren shpesh për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope.</p> <p>Për sa më sipër, për lëshimin e certifikatës për importim, eksportim, ruajtje dhe tregtim me shumicë të prekursorëve të drogës të kategorisë 3, dokumentat që kërkojnë të paraqiten në formë shkresore nga subjekti aplikues pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë:</p> <p>Kërkesë me shkrim ku të specifikohen substancat (sipas emërimit në përputhje me Ligjin nr. 8874, datë 29.3.2002 "Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope", sasia që do të importohet gjatë atij viti kalendarak dhe arsyet përse kërkojnë të importohen.) Fatura/invoice që dokumentojnë vendin nga do të importohet. Kopje e Kartës së identitetit të administratorit.</p> <p>Ju bëjnë me dije se, me fillimin e vitit 2024, aplikimi për certifikatën për importim, eksportim, ruajtje dhe tregtim me shumicë të prekursorëve të drogës të kategorisë 3 do të kryhet online nëpërmjet sistemit e-albania.</p>	E plotë
117	04.12.2023	21.12.2023	<p>Informacion rreth shërbimit paliativ në Republikën e Shqipërisë.</p>	<p>Informacion se në fushën e kujdesit paliativ është miratuar Ligji Nr. 138, datë 16.10.2014, "Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë". Janë miratuar 12 protokolle për kujdesin paliativ. Mjekët e familjes përkrahjnë të gjitha medikamentet e hormono-terapisë, që përfshihen tek ky kujdes. Kemi garantuar shërbim afër vendbanimit për çdo pacient që vuan nga patologjitë e kancerit duke ofruar shërbimin paliativ në 11 spitalele tona rajonale, dhe shërbimin e kimioterapisë në 8 spitalele rajonale. QSH SOB Tiranë ofron shërbime shëndetësore të kujdesit paliativ për të sëmurët me sëmundje onkologjike në stadi të avancuara dhe shumë të avancuara në banesë. Gjithashtu ky shërbim ofrohet dhe nga organizatat jofitimprurëse të licencuara, Ryder Tirana dhe Durës si dhe Mary Poter në Korçë. QSH SOB dhe organizatat jo fitimprurëse zbatojnë në mënyrë të detyrueshme të gjitha të drejtat e pacientëve të përcaktuara në kartën shoqëtare të të drejtave të pacientit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për rajonet që nuk ka ofruar privat të shërbimit paliativ, ndjekja dhe lëshimi i recetës bëhet nga mjeku i familjes. Në çdo spital funksionon shërbimi për pacientët që kanë nevojë për kujdes paliativ me disa shtrëtarë dhe personel shëndetësor që asistojnë pacientët. Barnat që nevojiten për ofrimin e këtij shërbimi, janë barnat e "listës esenciale" të kujdesit paliativ dhe sigurohen nga farmacia e Spitalit. Buxheti për shërbimin paliativ ndahet në buxhet për shërbimin parësor dhe spitalor. Të gjithë pacientëve iu ofrohet shërbim në banesë, barna me rimbursim dhe shërbim spitalor me shtrëtarë të dedikuara. Ky buxhet nuk është i veçantë, pasi pacientët marrin shërbim mjekësor në të gjitha shërbimet e specializuara sipas nozologjisë dhe komplikacioneve që vetë sëmundja shkakton. Fondi lidh kontratë me QSH SOB për financimin e shërbimeve shëndetësore të specializuara nga QSH SOB në kujdesin shëndetësor parësor të rrethit të Tiranës, për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momenti i daljes nga spitali deri në fund të jetës së tyre (kujdes paliativ). Fondi gjithashtu lidh kontratë me organizatat jofitimprurëse Ryder për një nga Fondi e së drejtës së lëshimit të recetës me rimbursim, nga mjeku i organizatës jofitimprurëse i certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ofrimin e kujdesit paliativ për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momenti i daljes nga spitali e në vazhdim. Krahasuar me vitin 2013, ku rimbursohesh vetëm morfina dhe analgjezikët opioidë, sot rimbursohen: tramadoli, oksikodoni, fentanyl, duke e çuar nivelin e kujdesit në nivelet bashkëkohore. Në listën e barnave që përdoren në kujdesin paliativ janë 92 barna me rimbursim. Shërbimet jepen pa asnjë lloj dallimi e diskriminimi, duke respektuar dhe ruajtjen plotësisht të shprehur dhe të dhënave dhe informacioneve të çdo personi, dajitetin dhe inimitetin e tij</p>	E plotë
118	11.12.2023	15.12.2023	<p>Informacion rreth funksionimit të Fondit Social i cili monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.</p>	<p>Informacion se Lidhur me këtë informacion, referojuni linkut: https://shendetesia.gov.al/njofitime-2/ Bazuar në Ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" mjetet financiare të Fondit Social të papërdorura në vitin fiskal ushtrimit nuk mund të mbarten në buxhetin e vitit pasardhës. Për më tepër informacion mund t'i drejtoheni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.</p>	E plotë